



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2528/ 6 prot.

Datë 27/10/2025

V E N D I M
Nr. 1533/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27/10/2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK, për procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-60955-09-10-2025*, me objekt: “*Upgrade Oracle JDE*”, me fond limit 14.959.147,03 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-60955-09-10-2025*, me objekt: “*Upgrade Oracle JDE*”, me fond limit 14.959.147,03 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK me NIPT: K21710002J dhe me adresë: *Rruga "Murat Toptani", Godina "Eurocol", Kati 8 Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Portual Durrës
Adresa: Lagja nr.1, Rruga "Tregtare", Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-60955-09-10-2025, me objekt: “Upgrade Oracle JDE”, me fond limit 14.959.147,03 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.

II.2. Në datën 17.09.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5820, datë 17.09.2025 dhe me numër protokoll nr. 2528/2025 prot., datë 17.09.2025 e operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kërkesën për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.5. Në datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ANKESË 3

Sa i përket kriterit ekonomik dhe financiar: “2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.”, AK ka perdorur nje baze ligjore te shfuqizuar në lidhje me argumentimin e këtij kriteri konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, sa i përket këtyre referencave ligjore të dyja janë tashmë të shfuqizuara pasi në fuqi aktualisht është -“UDHËZIM I PËRGJITHSHËM” Nr. 26, datë 8.9.2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT, -LIGJ Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT, ne nenin 70 te tij thuhet shprehimisht: “Aktet nënligjore 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim neneve 14, pika 3, 17, pika 6, 49 dhe 69 të këtij ligji. 2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij

ligji të nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe udhëzimin për transferimin e çmimit dhe marrëveshjet e çmimit në avancë. Si dhe në nenin 71 Shfuqizime “1. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shfuqizohet. 2. Pika 1 e nenit 9, si dhe kreu III i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shfuqizohet. AK kanë si detyrim ligjor që të argumentojnë dhe justifikojnë kriteret kualifikuese. Nderkohë argumentimi i bere nga AK mbeshetet në një bazë ligjore aktualisht të shfuqizuara.

Kërkesë 3:

Kërkojmë riargumentimin e këtij kriteri nga AK, bazuar në ligjin aktual.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 3:

ISHTE

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

BËHET

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për këtë pikë kërkesa pranohet.

ANKESË 11

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” **ne faqe 3** përcaktohet “... Sistemi i administrimit financiar JDE është i integruar me sistemet e tjera të APD-së si: sistemi Mainsaver, Payroll etj...”

Ne seksonin 2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori, të specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, NUK përcaktohet nëse sistemi i përmirësuar i administrimit financiar JDE, do të duhet të integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll.

Nëse sistemi i përmirësuar JDE do të duhet që të integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll, NUK ka të përcaktuar në dokumentin e specifikimeve teknike, ASNJE kërkesë teknike për integrimin dhe as ASNJE procedure testimi të këtij integrimi në versionin e përmirësuar të JDE.

Kërkesë 11.1:

AK të përcaktoje në dokumentin e specifikimeve teknike nëse sistemi i përmirësuar i administrimit financiar JDE, do të duhet të integrohet me sistemin Mainsaver, Payroll pasi nuk ka asnjë kërkesë teknike të përcaktuar për integrimin dhe testimin, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike.

Përgjigje Kërkesës 11.1

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmirësimi i sistemit financiar Oracle JD Edëards, duke përfshirë:

- përditësimin në versionin më të fundit (9.2),
- azhurnimin e Tools Release, EëbLogic, si dhe
- komponentë të tjerë bazë si baza e të dhënave (database) dhe sistemi operativ (OS) i platformës JDE.

Siç është përcaktuar në dokumentin e Termave të Referencës, **sistemi JD Edëards është aktualisht i integruar me sistemet Mainsaver dhe Payroll.** Procedura e shpallur nuk përfshin ndryshim, ri-konfigurim apo përmirësim të mënyrës ekzistuese të integritit me këto sisteme të palëve të treta. Gjithashtu, nuk kërkohet zhvillimi i moduleve shtesë apo testim i dedikuar mbi integritin ekzistues, pasi ky integritim do të vazhdojë të funksionojë në formën aktuale edhe pas përmirësimit të JD Edëards. Në këtë kuadër, nuk është e nevojshme të përfshihen specifikime teknike shtesë në dokumentacion, pasi procedura nuk përfshin ndërhyrje në sistemet e palëve të treta.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 12

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termet_e_References.docx” **ne faqe 7** përcaktohet se duhet të realizohet “... Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud...”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike **NUK ka të përcaktuar ASNJE kërkesë teknike për platformen cloud dhe nuk ASNJE procedure testimi të migrimit të infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar nga serverat fizik lokal ne Platformen Cloud.**

Kërkesë 12:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike specifikimet teknike të platformes cloud si edhe të përcaktojë procedura të qarta të testimit të migrimit të infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar nga serverat fizik lokal në Platformën Cloud, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 12:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përfshirë në mënyrë të qartë dhe të detajuar seksioni: **“12.1. Krijimi i Infrastrukturës Cloud për Sistemin e Administrimit Financiar Oracle JD Edëards”**, i cili përmban:

- përshkrimin e objektivit të migrimit në Cloud,

- specifikimet funksionale të mjedisit cloud që do të ofrohet nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, në seksionin 13. KËRKESAT TEKNIKE janë përcaktuar parametrat minimalë të instancave (makina virtuale) që duhet të jenë pjesë e këtij ambienti cloud, përfshirë:

- numrin e CPU-ve,
- kapacitetin e RAM-it,
- tipologjinë e storage-it,
- kapacitetin total, si dhe
- llojin e sistemit operativ.

Procedura aktuale parashikon ofrimin e një zgjidhjeje cloud të dizenuar dhe operuar nga vetë operatori ekonomik, i cili ka lirinë të propozojë konfigurimin teknik dhe modelin komercial më të përshtatshëm për nevojat e projektit. Procedurat e testimit të migrimit nuk kanë nevojë të detajohen në këtë fazë, pasi ato përbëjnë pjesë integrale të planit të implementimit që do të paraqitet dhe miratohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës. Të gjitha elementët thelbësorë të platformës cloud janë tashmë të adresuar në dokumentacionin teknik të seksioneve 12.1 dhe 13, duke mbuluar plotësisht kërkesat minimale funksionale dhe teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 14

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 7 percaktohet se do te duhet te realizohet “... Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e aplikacionit nga Eëindoës server 2008 R2 (64 bit) ne Eëindoës Server 2019 ose me lart, Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e bazes se te dhenave nga Red Hat Linux ne min, Oracle Linux 8.10.”

Ne dokumentin e specifikimeve teknike NUK ka te percaktuar procedura testimi te permiresimit te sistemeve te operimit Eëindoë dhe Oracle Linux.

Kërkesë 14:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat të testimit të përmirësimit të sistemeve të operimit Eëindoës dhe Oracle Linux.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 14:

Qëllimi i kësaj procedure është përmirësimi dhe azhurnimi i sistemit financiar Oracle JD Edëards, dhe në këtë kuadër kërkohet gjithashtu përmirësimi i sistemeve operative të serverëve ku ky sistem do të

vendoset. **Testimi i versioneve të sistemeve operative, si Ëindoës Server 2019 ose Oracle Linux 8.10, nuk është përgjegjësi e operatorit ekonomik, pasi ato janë produkte standarde të lëshuara nga prodhuesit përkatës, të cilët i kanë testuar dhe certifikuar zyrtarisht për përdorim.**

Si pjesë e implementimit të projektit, kërkesa minimale është që sistemi Oracle JD Edëards të jetë plotësisht funksional në mjedisin e azhurnuar, duke përfshirë sistemet operative, dhe të dorëzohet si i tillë në përfundim të kontratës. Pra, garancia e funksionalitetit nuk kërkon procedura të veçanta testimi për vetë OS-të, por testim të sistemit financiar mbi mjedisin e përmirësuar, që është objektivisht pjesë e procesit të dorëzimit të sistemit. Testimi i sistemeve operative si produkte të vendorëve globalë nuk është pjesë e kësaj procedure, për sa kohë ato përdoren në versionet zyrtare dhe të certifikuara nga vetë prodhuesit.

Kërkesa për përfshirjen e procedurave të veçanta testimi për përmirësimin e sistemeve operative nuk pranohet, pasi është jashtë objektit teknik të kontratës dhe nuk sjell vlerë të shtuar në raport me garantimin e funksionalitetit të sistemit financiar.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 15

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 7 përcaktohet se do të duhet të realizohet: **“Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar në Platformen Cloud...”**.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike **nuk përcaktohet se si APD si zotëruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar, garantohet që i dispononon të dhënat financiare që sistemi JDE administron, pas përfundimit të abonimit (subscription) në platformen cloud.**

Kërkesë 15:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat se si AK si zotëruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar, do të duhet që të garantohet se si do të posedojë (zotërojë) të dhënat financiare pas përfundimit të abonimit (subscription) në platformën cloud, pasi AK në përfundim të kontratës mund të ngrejë pretendime të ndryshme, të pa përcaktuara dhe të pa realizueshme që vënë OE në pozicionin e pamundësisë për realizimin e kontratës.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 15:

Në përputhje me objektin e kontratës dhe rolin e APD-së si autoritet publik dhe zotërues ligjor i sistemit të administrimit financiar, **të gjitha të dhënat financiare dhe operationale që përpunohen përmes JD Edëards janë dhe mbeten pronë e APD-së, nën kontrollin e saj të plotë. Projekti**

parashikon migrimin/hostimin e infrastrukturës në cloud me qëllim sigurimin e disponueshmërisë, shkallëzueshmërisë dhe sigurisë, por nuk ndryshon titullin e pronësisë mbi të dhënat: operatori ekonomik ofron platformën dhe shërbimin e hostimit dhe nuk fiton asnjë të drejtë dispozitive mbi përmbajtjen.

Kjo qasje është në vijimësi të praktikës së APD-së me sisteme të tjera të ngjashme të hostuara në cloud. Në këto marrëdhënie, APD-ja mban aksesin e pakufizuar te të dhënat, përcakton politikat e ruajtjes, rezervimeve (backup), rikuperimit dhe arkivimit, si dhe autorizon çdo eksport ose transfer. Operatorit i takon të sigurojë mjedisin, masat e sigurisë dhe reversueshmërinë e shërbimit, por jo të kufizojë përdorimin, eksportin apo migrimin e të dhënave.

Në përfundim të periudhës së shërbimit ose sa herë që kërkohet nga APD, operatori është i detyruar të dorëzojë në mënyrë të plotë të dhënat dhe kopjet rezervë në formate të zakonshme e të dokumentuara (p.sh. dump i bazës së të dhënave, eksporte të skedarëve dhe konfigurimeve), së bashku me udhëzimet e rikthimit dhe metadatat e nevojshme për rindërtim. Dorëzimi duhet të shoqërohet me kontrolle integriteti (p.sh. hash/checksum), listë inventari dhe provë të riprodhueshmërisë në mjedis të APD-së. Gjatë tranzicionit, operatori siguron asistencën e domosdoshme teknike (exit/transition assistance), dritaret e aksesit, personelin kontaktues dhe koordinimin e hapave, në mënyrë që kalimi të jetë i plotë dhe i verifikueshëm.

Pas dorëzimit dhe verifikimit, operatori kryen fshirjen e sigurt të çdo kopjeje që mban në infrastrukturën e tij, sipas një procedure të auditueshme dhe të provueshme me certifikim fshirjeje, duke respektuar njëkohësisht afatet ligjore të ruajtjes së log-eve dhe gjurmëve të auditimit. Çështje si vendndodhja e të dhënave (data residency), enkriptimi në transit dhe në pushim, menaxhimi i çelësave, si dhe qasja e kontrolluar gjatë trajtimit të incidenteve, adresohen në planin e sigurisë dhe në marrëveshjen e nivelit të shërbimit (SLA).

Për këto arsye, nuk ka nevojë të futen specifikime të tjera teknike shtesë në Termat e Referencës lidhur me zotërimin e të dhënave. Pronësia e APD-së është e qartë ligjërisht dhe praktikisht, ndërsa elementet ekzekutive dhe sanksionuese rregullohen saktë në kontratë/SLA. Pikërisht aty përcaktohen parametrat operacionalë si RTO/RPO, frekuencat e backup-eve, afatet dhe formatet e dorëzimit, të drejtat e auditimit, masat ndëshkuese për mosrespektim dhe përgjegjësitë gjatë fazës së tranzicionit. Mbajtja e TOR-it në nivel kërkesash funksionale dhe jo në detaje operative shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe siguron fleksibilitet për zgjidhjen më të mirë teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 16

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 10 percaktohet se sistemi i permiresuar do te duhet te jete ne perputhje me “. Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) duhet të jenë pjesë integrale në sistem, në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimi i tyre. ”

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk percaktohet se si AK si zoteruesi i te dhenave te sistemit te administrimit financiar JDE, garantohet qe sistemi ne platformen cloud do te jete ne perputhje me Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

AK do te duhet te percaktoje specifikimet teknike per sigurine ne perputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

Kërkesë 16:

AK në dokumentin e specifikimeve, të percaktojë specifikimet teknike për sigurinë në përputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 16:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përcaktuar qartë dhe me qëllim që sistemi i përmirësuar JD Edwards, i cili do të migrohet dhe operojë në mjedis cloud, duhet të jetë në përputhje me çdo rregullore në fuqi dhe me çdo rregullore të re të nxjerrë nga AKSK (**jo AKCESK**) që lidhet me:

- sigurinë e informacionit,
- parandalimin e cenueshmërisë (vulnerability management),
- azhurnimin/patching-un e sistemeve operuese, të bazës së të dhënave dhe aplikacioneve,
- autentifikimin, logimin, mbrojtjen ndaj sulmeve, etj.

Ky formulim i vendos përgjegjësi të drejtpërdrejtë OE-së që zgjidhja teknike e ofruar (infrastruktura cloud dhe sistemi financiar) të jetë gjithmonë e përditësuar dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë që janë në fuqi ose që mund të hyjnë në fuqi gjatë zbatimit të kontratës. Kjo përfshin, ndër të tjera: aplikimin e rregullt të patch-eve të sigurisë për OS/DB/JDE, aktivizimin e auditimeve, menaxhimin e aksesit të privilegjuar, enkriptimin e të dhënave në transit dhe në pushim, si dhe masa operative për zbulim dhe reagim ndaj incidenteve.

Gjithashtu, zbatimi duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo nënkupton respektimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e riskut kibernetik, raportimin e incidenteve dhe ruajtjen e gjurmëve të auditimit, brenda afateve dhe formateve të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e AKSK.

Përvoja ekzistuese me sisteme të tjerë kritikë tregon se zbatimi i kërkesave të AKSK dhe i ligjit realizohet përmes politikave dhe procedurave institucionale të operimit ditor (plan i sigurisë, patch management, incident response, backup/DR, etj.) dhe nuk kërkon specifikime teknike më të detajuara në fazën e prokurimit. Për rrjedhojë, kjo kërkesë trajtohet si sqarim: dokumenti ekzistues e parashikon qartë përputhshmërinë me AKSK dhe me Ligjin nr. 25/2024, dhe çdo OE është i detyruar të ofrojë një zgjidhje që i respekton këto rregulla, për të mos rrezikuar sigurinë kibernetike të sistemit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 17

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 15 përcaktohet se OE do të duhet të kryejë “Kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk ka të përcaktuar nese “log softëare” janë logs te bazes se te dhenave (Oracle Database), janë logs te serverit te aplikimeve(Oracle Ëeblogic) apo janë logs te platformes cloud ku do te hostohet sistemi i permiresuar.

Kerkesa e AK e shkruar ne menyre te pergjithshme, shkakton konfuzion tek OE-te dhe OE-ve, AK mund tu kerkoje log-e te tjera te bazes se te dhenave (Oracle Database), te serverit te aplikimeve(Oracle Ëeblogic) apo jane logs te platformes cloud , pune te paparashikuara qe kane impakt financiar.

Kërkesë 17:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike të gjithë loget softëare që OE duhet të kontrollojë gjatë SLA.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 17:

Qëllimi i këtij detyrimi është që operatori ekonomik (OE) të garantojë monitorim të plotë dhe të vazhdueshëm të sistemit financiar JD Edëards në të gjithë shtresën softëare, për të identifikuar, parandaluar dhe trajtuar në kohë çdo problem teknik ose të sigurisë. Formulimi “kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare” ka kuptim gjithëpërfshirës dhe mbulon, pa kufizim:

- Application logs:
 - JD Edëards EnterpriseOne logs
 - ËebLogic Server logs
- Database logs:
 - Alert logs
 - Listener logs
 - Audit logs

- Operating system logs: Linux dhe Ëindoës Server, për aq sa ndikojnë funksionimin e JDE
- Cloud infrastructure logs: në masën që ofrohen nga platforma cloud dhe lidhen me performancën/sigurinë e hostimit të sistemit financiar

Kjo nuk shton detyra të reja të paparashikuara; thjesht kërkon që të gjitha komponentët që ndikojnë JDE të jenë nën vëzhgim dhe analizë, si pjesë e shërbimit të mirëmbajtjes dhe të SLA-së. Për zbatim korrekt, OE duhet të sigurojë këto parime operative (pa ndryshuar objektin teknik të kontratës):

- Qendërzim i log-eve në një mjedis të vetëm analitik (p.sh. SIEM/observability), me korrelacion ngjarjesh dhe alarmim sipas pragjeve të dakordësuara në SLA.
- Integritet dhe gjurmueshmëri: time-stamping i saktë (sinkronizim NTP), ruajtje e paprekshme/ e verifikueshme (p.sh. hash), historik auditimi për akseset/veprimet.
- Kontroll i aksesit me role (RBAC) dhe ndarje detyrash; maskim të dhënash, kur është e nevojshme.
- Retention dhe disponueshmëri: ruajtje e log-eve sipas afateve të SLA-së dhe rregulloreve në fuqi; log-et duhet të jenë të kërkueshme dhe të eksportueshme për hetim/raportim incidentesh.

Kjo kërkesë është sqarim, jo ndryshim i specifikimeve: termi “log-e softëare” në dokumentin e specifikimeve teknike tashmë i përfshin këto kategori dhe praktikat përkatëse të administrimit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.”.

II.6. Me shkresën nr. 3423 prot, datë 23.09.2025 “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/2 prot, datë 25.09.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ANKESË 3

Sa i përket kriterit ekonomik dhe financiar: “2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.”, AK ka perdorur nje baze ligjore te shfuqizuar në lidhje me argumentimin e këtij kriteri konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkueshme për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, sa i përket

këtyre referencave ligjore të dyja janë tashmë të shfuqizuara pasi në fuqi aktualisht është - “UDHËZIM I PËRGJITHSHËM” Nr. 26, datë 8.9.2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT,

-LIGJ Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT, në nenin 70 të tij thuhet shprehimisht: “Aktet nënligjore 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim nënve 14, pika 3, 17, pika 6, 49 dhe 69 të këtij ligji. 2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe udhëzimin për transferimin e çmimit dhe marrëveshjet e çmimit në avancë. Si dhe në nenin

71 Shfuqizime “1. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shfuqizohet. 2. Pika 1 e nenit 9, si dhe kreu III i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

AK kanë si detyrim ligjor që të argumentojnë dhe justifikojnë kriteret kualifikuese. Nderkohë argumentimi i bere nga AK mbeshetet në një bazë ligjore aktualisht të shfuqizuara.

Kërkesë 3:

Kërkojmë riargumentimin e këtij kriteri nga AK, bazuar në ligjin aktual.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 3:

ISHTE

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurrohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur

duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

BËHET

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për këtë pikë kërkesa pranohet.

ANKESË 11

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” **ne faqe 3** percaktohet “... Sistemi i administrimit financiar JDE është i integruar me sistemet e tjera të APD-së si: sistemi Mainsaver, Payroll etj...”

Ne seksonin 2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori, te specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi, **NUK** percaktohet nese sistemi i permiresuar i administrimit financiar JDE, **do te duhet te integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll.**

Nese sistemi i permiresuar JDE do te duhet qe te integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll, **NUK** ka te percaktuar ne dokumentin e specifikimeve teknike, **ASNJE** kerkese teknike per integrimin dhe as **ASNJE** procedure testimi te ketij integrimi ne versionin e permiresuar te JDE.

Kërkesë 11.1:

AK të përcaktoje në dokumentin e specifikimeve teknike nëse sistemi i përmirësuar i administrimit financiar JDE, do të duhet të integrohet me sistemin Mainsaver, Payroll pasi nuk ka asnjë kërkesë teknike të përcaktuar për integrimin dhe testimin, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike.

Përgjigje Kërkesës 11.1

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmirësimi i sistemit financiar Oracle JD Edëards, duke përfshirë:

- përditësimin në versionin më të fundit (9.2),
- azhurnimin e Tools Release, EebLogic, si dhe
- komponentë të tjerë bazë si baza e të dhënave (database) dhe sistemi operativ (OS) i platformës JDE.

Siç është përcaktuar në dokumentin e Termave të Referencës, sistemi JD Edëards është aktualisht i integruar me sistemet Mainsaver dhe Payroll. Procedura e shpallur nuk përfshin ndryshim, ri-konfigurim apo përmirësim të mënyrës ekzistuese të integrimit me këto sisteme të palëve të treta. Gjithashtu, nuk kërkohet zhvillimi i moduleve shtesë apo testim i dedikuar mbi integrimin ekzistues, pasi ky integrim do të vazhdojë të funksionojë në formën aktuale edhe pas përmirësimit të JD Edëards. Në këtë kuadër, nuk është e nevojshme të përfshihen specifikime teknike shtesë në dokumentacion, pasi procedura nuk përfshin ndërhyrje në sistemet e palëve të treta.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 12

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” **ne faqe 7 percaktohet se duhet te realizohet “... Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud...”.**

Ne dokumentin e specifikimeve teknike **NUK ka te percaktuar ASNJE kerkese teknike per platformen cloud dhe nuk ASNJE procedure testimi te migrimit te infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar nga serverat fizik lokal ne Platformen Cloud.**

Kërkesë 12:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike specifikimet teknike të platformes cloud si edhe të përcaktojë procedura të garta të testimit të migrimit të infrastrukturës së sistemit të

administrimit financiar nga serverat fizik lokal në Platformën Cloud, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 12:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përfshirë në mënyrë të qartë dhe të detajuar seksioni: “12.1. Krijimi i Infrastrukturës Cloud për Sistemin e Administrimit Financiar Oracle JD Edëards”, i cili përmban:

- përshkrimin e objektivit të migrimit në Cloud,
- specifikimet funksionale të mjedisit cloud që do të ofrohet nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, në seksionin 13. KËRKESAT TEKNIKE janë përcaktuar parametrat minimalë të instancave (makina virtuale) që duhet të jenë pjesë e këtij ambienti cloud, përfshirë:

- numrin e CPU-ve,
- kapacitetin e RAM-it,
- tipologjinë e storage-it,
- kapacitetin total, si dhe
- llojin e sistemit operativ.

Procedura aktuale parashikon ofrimin e një zgjidhjeje cloud të dizenuar dhe operuar nga vetë operatori ekonomik, i cili ka lirinë të propozojë konfigurimin teknik dhe modelin komercial më të përshtatshëm për nevojat e projektit. Procedurat e testimit të migrimit nuk kanë nevojë të detajohen në këtë fazë, pasi ato përbëjnë pjesë integrale të planit të implementimit që do të paraqitet dhe miratohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës. Të gjitha elementët thelbësorë të platformës cloud janë tashmë të adresuar në dokumentacionin teknik të seksioneve 12.1 dhe 13, duke mbuluar plotësisht kërkesat minimale funksionale dhe teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 14

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kesaj procedure prokurimi “2_Termit_e_References.docx” ne faqe 7 percaktohet se do te duhet te realizohet “... Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e aplikacionit nga Eëindoës server 2008 R2 (64 bit) ne Eëindoës Server 2019 ose me lart, Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e bazes se te dhenave nga Red Hat Linux ne min, Oracle Linux 8.10.

”

Ne dokumentin e specifikimeve teknike NUK ka te percaktuar procedura testimi te permiresimit te sistemeve te operimit Eëindoë dhe Oracle Linux.

Kërkesë 14:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat të testimit të përmirësimit të sistemeve të operimit Eëindoës dhe Oracle Linux.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 14:

Qëllimi i kësaj procedure është përmirësimi dhe azhornimi i sistemit financiar Oracle JD Edëards, dhe në këtë kuadër kërkohet gjithashtu përmirësimi i sistemeve operative të serverëve ku ky sistem do të vendoset. Testimi i versioneve të sistemeve operative, si Eëindoës Server 2019 ose Oracle Linux 8.10, nuk është përgjegjësi e operatorit ekonomik, pasi ato janë produkte standarde të lëshuara nga prodhuesit përkatës, të cilët i kanë testuar dhe certifikuar zyrtarisht për përdorim.

Si pjesë e implementimit të projektit, kërkesa minimale është që sistemi Oracle JD Edëards të jetë plotësisht funksional në mjedisin e azhornuar, duke përfshirë sistemet operative, dhe të dorëzohet si i tillë në përfundim të kontratës. Pra, garancia e funksionalitetit nuk kërkon procedura të veçanta testimi për vetë OS-të, por testim të sistemit financiar mbi mjedisin e përmirësuar, që është objektivisht pjesë e procesit të dorëzimit të sistemit. Testimi i sistemeve operative si produkte të vendorëve globalë nuk është pjesë e kësaj procedure, për sa kohë ato përdoren në versionet zyrtare dhe të certifikuara nga vetë prodhuesit.

Kërkesa për përfshirjen e procedurave të veçanta testimi për përmirësimin e sistemeve operative nuk pranohet, pasi është jashtë objektit teknik të kontratës dhe nuk sjell vlerë të shtuar në raport me garantimin e funksionalitetit të sistemit financiar.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 15

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” **ne faqe 7** percaktohet se do te duhet te realizohet: “Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud...”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk percaktohet se si APD si zoteruesi i te dhenave te sistemit te administrimit finaciari, garantohet qe i dispononon te dhenat financiare qe sistemi JDE administron, pas perfundimit te abonimit (subscription) ne platformen cloud.

Kërkesë 15:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat se si AK si zotëruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar, do të duhet që të garantohet se si do ti posedojë (zotërojë) të dhënat financiare pas përfundimit të abonimit (subscription) në platformën cloud, pasi AK në përfundim të kontratës mund të ngrejë pretendime të ndryshme, të pa përcaktuara dhe të pa realizueshme që vënë OE në pozicionin e pamundësisë për realizimin e kontratës.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 15:

*Në përputhje me objektin e kontratës dhe rolin e APD-së si autoritet publik dhe zotërues ligjor i sistemit të administrimit financiar, **të gjitha të dhënat financiare dhe operacionale që përpunohen përmes JD Edëards janë dhe mbeten pronë e APD-së, nën kontrollin e saj të plotë. Projekti parashikon migrimin/hostimin e infrastrukturës në cloud me qëllim sigurimin e disponueshmërisë, shkallëzueshmërisë dhe sigurisë, por nuk ndryshon titullin e pronësisë mbi të dhënat: operatori ekonomik ofron platformën dhe shërbimin e hostimit dhe nuk fiton asnjë të drejtë dispozitive mbi përmbajtjen.***

Kjo qasje është në vijimësi të praktikës së APD-së me sisteme të tjera të ngjashme të hostuara në cloud. Në këto marrëdhënie, APD-ja mban aksesin e pakufizuar të të dhënave, përcakton politikën e ruajtjes, rezervimeve (backup), rikuperimit dhe arkivimit, si dhe autorizon çdo eksport ose transfer. Operatorit i takon të sigurojë mjedisin, masat e sigurisë dhe reversueshmërinë e shërbimit, por jo të kufizojë përdorimin, eksportin apo migrimin e të dhënave.

Në përfundim të periudhës së shërbimit ose sa herë që kërkohet nga APD, operatori është i detyruar të dorëzojë në mënyrë të plotë të dhënat dhe kopjet rezervë në formate të zakonshme e të dokumentuara (p.sh. dump i bazës së të dhënave, eksporte të skedarëve dhe konfigurimeve), së bashku me udhëzimet e rikthimit dhe metadatat e nevojshme për rindërtim. Dorëzimi duhet të shoqërohet me kontrolle integriteti (p.sh. hash/checksum), listë inventari dhe provë të riprodhueshmërisë në mjedis të APD-së. Gjatë tranzicionit, operatori siguron asistencën e domosdoshme teknike (exit/transition assistance), dritaret e aksesit, personelin kontaktues dhe koordinimin e hapave, në mënyrë që kalimi të jetë i plotë dhe i verifikueshëm.

Pas dorëzimit dhe verifikimit, operatori kryen fshirjen e sigurt të çdo kopjeje që mban në infrastrukturën e tij, sipas një procedure të auditueshme dhe të provueshme me certifikim fshirjeje, duke respektuar njëkohësisht afatet ligjore të ruajtjes së log-eve dhe gjurmëve të auditimit. Çështje si vendndodhja e të dhënave (data residency), enkriptimi në transit dhe në pushim, menaxhimi i çelësave, si dhe qasja e kontrolluar gjatë trajtimit të incidenteve, adresohen në planin e sigurisë dhe në marrëveshjen e nivelit të shërbimit (SLA).

Për këto arsye, nuk ka nevojë të futen specifikime të tjera teknike shtesë në Termat e Referencës lidhur me zotërimin e të dhënave. Pronësia e APD-së është e qartë ligjërisht dhe praktikisht, ndërsa

elementet ekzekutive dhe sanksionuese rregullohen saktë në kontratë/SLA. Pikërisht aty përcaktohen parametrat operacionalë si RTO/RPO, frekuencat e backup-eve, afatet dhe formatet e dorëzimit, të drejtat e auditimit, masat ndëshkuese për mosrespektim dhe përgjegjësitë gjatë fazës së tranzicionit. Mbajtja e TOR-it në nivel kërkesash funksionale dhe jo në detaje operative shmanë kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe siguron fleksibilitet për zgjidhjen më të mirë teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 16

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” në faqe 10 përcaktohet se sistemi i përmirësuar do të duhet të jetë në përputhje me “. Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) duhet të jenë pjesë integrale në sistem, në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimi i tyre.”

Ne dokumentin e specifikimeve teknike **nuk përcaktohet se si AK si zoteruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar JDE, garantohet që sistemi në platformen cloud do të jetë në përputhje me Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).**

AK do të duhet të përcaktojë specifikimet teknike për sigurinë në përputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

Kërkesë 16:

AK në dokumentin e specifikimeve, të përcaktojë specifikimet teknike për sigurinë në përputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 16:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përcaktuar qartë dhe me qëllim që sistemi i përmirësuar JD Edwards, i cili do të migrohet dhe operojë në mjedis cloud, duhet të jetë në përputhje me çdo rregullore në fuqi dhe me çdo rregullore të re të nxjerrë nga AKSK (jo AKCESK) që lidhet me:

- sigurinë e informacionit,
- parandalimin e cenueshmërisë (vulnerability management),
- azhurnimin/patching-un e sistemeve operuese, të bazës së të dhënave dhe aplikacioneve,
- autentifikimin, logimin, mbrojtjen ndaj sulmeve, etj.

Ky formulim i vendos përgjegjësi të drejtpërdrejtë OE-së që zgjidhja teknike e ofruar (infrastruktura cloud dhe sistemi financiar) të jetë gjithmonë e përditësuar dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë që janë në fuqi ose që mund të hyjnë në fuqi gjatë zbatimit të kontratës. Kjo përfshin, ndër të tjera:

aplikimin e rregullt të patch-eve të sigurisë për OS/DB/JDE, aktivizimin e auditimeve, menaxhimin e aksesit të privilegjuar, enkriptimin e të dhënave në transit dhe në pushim, si dhe masa operative për zbulim dhe reagim ndaj incidenteve.

Gjithashtu, zbatimi duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo nënkupton respektimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e riskut kibernetik, raportimin e incidenteve dhe ruajtjen e gjurmëve të auditimit, brenda afateve dhe formateve të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e AKSK.

Përvoja ekzistuese me sisteme të tjerë kritikë tregon se zbatimi i kërkesave të AKSK dhe i ligjit realizohet përmes politikave dhe procedurave institucionale të operimit ditor (plan i sigurisë, patch management, incident response, backup/DR, etj.) dhe nuk kërkon specifikime teknike më të detajuara në fazën e prokurimit. Për rrjedhojë, kjo kërkesë trajtohet si sqarim: dokumenti ekzistues e parashikon qartë përputhshmërinë me AKSK dhe me Ligjin nr. 25/2024, dhe çdo OE është i detyruar të ofrojë një zgjidhje që i respekton këto rregulla, për të mos rrezikuar sigurinë kibernetike të sistemit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 17

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 15 përcaktohet se OE do të duhet të kryejë “Kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk ka të përcaktuar nese “log softëare” janë logs te bazes se te dhenave (Oracle Database), janë logs te serverit te aplikimeve(Oracle Eëblogic) apo janë logs te platformes cloud ku do te hostohet sistemi i permiresuar.

Kërkesa e AK e shkruar në mënyrë të përgjithshme, shkakton konfuzion tek OE-te dhe OE-ve, AK mund të kërkojë log-e të tjera të bazes së të dhënave (Oracle Database), të serverit të aplikimeve(Oracle Eëblogic) apo janë logs të platformes cloud, punë të paparashikuara që kanë impakt financiar.

Kërkesë 17:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike të gjithë loget softëare që OE duhet të kontrollojë gjatë SLA.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 17:

Qëllimi i këtij detyrimi është që operatori ekonomik (OE) të garantojë monitorim të plotë dhe të vazhdueshëm të sistemit financiar JD Edwards në të gjithë shtresën softëare, për të identifikuar,

parandaluar dhe trajtuar në kohë çdo problem teknik ose të sigurisë. Formulimi “kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare” ka kuptim gjithëpërfshirës dhe mbulon, pa kufizim:

- Application logs:
 - JD Edwards EnterpriseOne logs
 - ËebLogic Server logs
- Database logs:
 - Alert logs
 - Listener logs
 - Audit logs
- Operating system logs: Linux dhe Ëindoës Server, për aq sa ndikojnë funksionimin e JDE
- Cloud infrastructure logs: në masën që ofrohen nga platforma cloud dhe lidhen me performancën/sigurinë e hostimit të sistemit financiar

Kjo nuk shton detyra të reja të paparashikuara; thjesht kërkon që të gjitha komponentët që ndikojnë JDE të jenë nën vëzhgim dhe analizë, si pjesë e shërbimit të mirëmbajtjes dhe të SLA-së. Për zbatim korrekt, OE duhet të sigurojë këto parime operative (pa ndryshuar objektin teknik të kontratës):

- Qendëzimi i log-eve në një mjedis të vetëm analitik (p.sh. SIEM/observability), me korrelacion ngjarjesh dhe alarmim sipas pragjeve të dakordësuara në SLA.
- Integritet dhe gjurmueshmëri: time-stamping i saktë (sinkronizim NTP), ruajtje e paprekshme/ e verifikueshme (p.sh. hash), historik auditimi për akseset/veprimet.
- Kontroll i aksesit me role (RBAC) dhe ndarje detyrash; maskim të dhënash, kur është e nevojshme.
- Retention dhe disponueshmëri: ruajtje e log-eve sipas afateve të SLA-së dhe rregulloreve në fuqi; log-et duhet të jenë të kërkueshme dhe të eksportueshme për hetim/raportim incidentesh.

Kjo kërkesë është sqarim, jo ndryshim i specifikimeve: termi “log-e softëare” në dokumentin e specifikimeve teknike tashmë i përfshin këto kategori dhe praktikat përkatëse të administrimit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.”.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK në lidhje me vendimarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave referuar shkresës nr. 3423 prot, datë 23.09.2025 “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, duke qënë se nuk është dakort, më datë 09.10.2025 ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumenta shtesë (prapësime) lidhur me këtë vendimarrje, të cilat janë protokolluar me tonën me nr. 2528/3 prot, datë 09.10.2025.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK, për **riargumentimin** e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekoomik dhe financiar” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të parashtruar në **Ankesën nr. 3**, lidhur me **kërkesën për sqarim** përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 2.3, të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të parashtruar në **Ankesën nr. 11**, lidhur me **kërkesat për sqarim** përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 2.1, të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të parashtruara përkatësisht në **Ankesën nr. 12**, **Ankesën nr.14** dhe **Ankesën 15**, lidhur me **kërkesën për sqarim** përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 4.1.4 të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të parashtruar në **Ankesën nr. 16**, si dhe lidhur me **kërkesën për sqarim** përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 8 të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të parashtruar në **Ankesën nr. 17**, të parashtruara nga ana e ankimuesit në fomularin e ankesës së ankimit me numër ankimi elektronik A/2025/5820 dhe me numër protokoll nr. 2528/2025 prot., datë 17.092025, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datë 11.08.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “*Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ANKESË 3

Sa i përket kriterit ekonomik dhe financiar: “2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre

viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.”, AK ka perdorur nje baze ligjore te shfuqizuar në lidhje me argumentimin e këtij kriteri konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, sa i përket këtyre referencave ligjore të dyja janë tashmë të shfuqizuara pasi në fuqi aktualisht është -“UDHËZIM I PËRGJITHSHËM” Nr. 26, datë 8.9.2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT, -LIGJ Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT, ne nenin 70 te tij thuhet shprehimisht: “Aktet nënligjore 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim neneve 14, pika 3, 17, pika 6, 49 dhe 69 të këtij ligji. 2. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda një periudhe 3-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë udhëzimin e përgjithshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe udhëzimin për transferimin e çmimit dhe marrëveshjet e çmimit në avancë. Si dhe ne nenin 71 Shfuqizime “1. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shfuqizohet. 2. Pika 1 e nenit 9, si dhe kreu III i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shfuqizohet. AK kanë si detyrim ligjor që të argumentojnë dhe justifikojnë kriteret kualifikuese. Nderkohë argumentimi i bere nga AK mbeshetet në një bazë ligjore aktualisht te shfuqizuar.

Kërkesë 3:

Kërkojmë riargumentimin e këtij kriteri nga AK, bazuar në ligjin aktual.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 3:

ISHTE

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave

nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

BËHET

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar gjatë tre viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një me vlerë të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për këtë pikë kërkesa pranohet.

ANKESË 11

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi "2_Termat_e_References.docx" **ne faqe 3** përcaktohet "... Sistemi i administrimit financiar JDE është i integruar me sistemet e tjera të APD-së si: sistemi Mainsaver, Payroll etj..."

Ne seksonin 2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori, të specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, NUK përcaktohet nese sistemi i përmirësuar i administrimit financiar JDE, do të duhet të integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll.

Nese sistemi i permiresuar JDE do te duhet qe te integrohet me sistemin Mainsaver dhe Payroll, NUK ka te percaktuar ne dokumentin e specifikimeve teknike, ASNJE kerkese teknike per integrimin dhe as ASNJE procedure testimi te ketij integrimi ne versionin e permiresuar te JDE.

Kërkesë 11.1:

AK të përcaktoje në dokumentin e specifikimeve teknike nëse sistemi i përmirësuar i administrimit financiar JDE, do të duhet të integrohet me sistemin Mainsaver, Payroll pasi nuk ka asnjë kërkesë teknike të përcaktuar për integrimin dhe testimin, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike.

Përgjigje Kërkesës 11.1

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është përmirësimi i sistemit financiar Oracle JD Edwards, duke përfshirë:

- përditësimin në versionin më të fundit (9.2),
- azhurnimin e Tools Release, EebLogic, si dhe
- komponentë të tjerë bazë si baza e të dhënave (database) dhe sistemi operativ (OS) i platformës JDE.

Siç është përcaktuar në dokumentin e Termave të Referencës, sistemi JD Edwards është aktualisht i integruar me sistemet Mainsaver dhe Payroll. Procedura e shpallur nuk përfshin ndryshim, ri-konfigurim apo përmirësim të mënyrës ekzistuese të integritit me këto sisteme të palëve të treta. Gjithashtu, nuk kërkohet zhvillimi i moduleve shtesë apo testim i dedikuar mbi integrimin ekzistues, pasi ky integrim do të vazhdojë të funksionojë në formën aktuale edhe pas përmirësimit të JD Edwards. Në këtë kuadër, nuk është e nevojshme të përfshihen specifikime teknike shtesë në dokumentacion, pasi procedura nuk përfshin ndërhyrje në sistemet e palëve të treta.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 12

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi “2_Termet_e_References.docx” ne faqe 7 percaktohet se duhet te realizohet “... Migrimin i infrastkutures së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud...”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike NUK ka te percaktuar ASNJE kerkese teknike per platformen cloud dhe nuk ASNJE procedure testimi te migrimit te infrastkutures së sistemit të administrimit financiar nga serverat fizik lokal ne Platformen Cloud.

Kërkesë 12:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike specifikimet teknike të platformes cloud si edhe të përcaktojë procedura të qarta të testimit të migrimit të infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar nga serverat fizik lokal në Platformën Cloud, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 12:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përfshirë në mënyrë të qartë dhe të detajuar seksioni: “12.1. Krijimi i Infrastrukturës Cloud për Sistemin e Administrimit Financiar Oracle JD Edëards”, i cili përmban:

- përshkrimin e objektivit të migrimit në Cloud,
- specifikimet funksionale të mjedisit cloud që do të ofrohet nga operatori ekonomik.

Gjithashtu, në seksionin 13. KËRKESAT TEKNIKE janë përcaktuar parametrat minimalë të instancave (makina virtuale) që duhet të jenë pjesë e këtij ambienti cloud, përfshirë:

- numrin e CPU-ve,
- kapacitetin e RAM-it,
- tipologjinë e storage-it,
- kapacitetin total, si dhe
- llojin e sistemit operativ.

Procedura aktuale parashikon ofrimin e një zgjidhjeje cloud të dizenuar dhe operuar nga vetë operatori ekonomik, i cili ka lirinë të propozojë konfigurimin teknik dhe modelin komercial më të përshtatshëm për nevojat e projektit. Procedurat e testimit të migrimit nuk kanë nevojë të detajohen në këtë fazë, pasi ato përbëjnë pjesë integrale të planit të implementimit që do të paraqitet dhe miratohet gjatë fazës së zbatimit të kontratës. Të gjitha elementët thelbësorë të platformës cloud janë tashmë të adresuar në dokumentacionin teknik të seksioneve 12.1 dhe 13, duke mbuluar plotësisht kërkesat minimale funksionale dhe teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 14

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kesaj procedure prokurimi “2_Termet_e_References.docx” ne faqe 7 përcaktohet se do të duhet të realizohet “... Përmirësimi i sistemit të Operimit për serverin e aplikacionit nga Ëindoës server 2008 R2 (64 bit) në Ëindoës Server 2019 ose me lart, Përmirësimi i sistemit të Operimit për serverin e bazës së të dhënave nga Red Hat Linux në min, Oracle Linux 8.10.

”

Ne dokumentin e specifikimeve teknike NUK ka te percaktuar procedura testimi te permiresimit te sistemeve te operimit Eëindoë dhe Oracle Linux.

Kërkesë 14:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat të testimit të përmirësimit të sistemeve të operimit Eëindoës dhe Oracle Linux.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 14:

Qëllimi i kësaj procedure është përmirësimi dhe azhornimi i sistemit financiar Oracle JD Edëards, dhe në këtë kuadër kërkohet gjithashtu përmirësimi i sistemeve operative të serverëve ku ky sistem do të vendoset. Testimi i versioneve të sistemeve operative, si Eëindoës Server 2019 ose Oracle Linux 8.10, nuk është përgjegjësi e operatorit ekonomik, pasi ato janë produkte standarde të lëshuara nga prodhuesit përkatës, të cilët i kanë testuar dhe certifikuar zyrtarisht për përdorim.

Si pjesë e implementimit të projektit, kërkesa minimale është që sistemi Oracle JD Edëards të jetë plotësisht funksional në mjedisin e azhornuar, duke përfshirë sistemet operative, dhe të dorëzohet si i tillë në përfundim të kontratës. Pra, garancia e funksionalitetit nuk kërkon procedura të veçanta testimi për vetë OS-të, por testim të sistemit financiar mbi mjedisin e përmirësuar, që është objektivisht pjesë e procesit të dorëzimit të sistemit. Testimi i sistemeve operative si produkte të vendorëve globalë nuk është pjesë e kësaj procedure, për sa kohë ato përdoren në versionet zyrtare dhe të certifikuara nga vetë prodhuesit.

Kërkesa për përfshirjen e procedurave të veçanta testimi për përmirësimin e sistemeve operative nuk pranohet, pasi është jashtë objektit teknik të kontratës dhe nuk sjell vlerë të shtuar në raport me garantimin e funksionalitetit të sistemit financiar.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 15

Ne dokumentin e specifikimeve teknike te kesaj procedure prokurimi "2_Termat_e_References.docx" **ne faqe 7** percaktohet se do te duhet te realizohet: "Migrimin i infrastkutures së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud...".

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk percaktohet se si APD si zoteruesi i te dhenave te sistemit te administrimit finaciari, garantohet qe i dispononon te dhenat financiare qe sistemi JDE administron, pas perfundimit te abonimit (subscription) ne platformen cloud.

Kërkesë 15:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike procedurat se si AK si zotëruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar, do të duhet që të garantohet se si do ti posedojë (zotërojë) të dhënat financiare pas përfundimit të abonimit (subscription) në platformën cloud, pasi AK në përfundim të kontratës mund të ngrejë pretendime të ndryshme, të pa përcaktuara dhe të pa realizueshme që vënë OE në pozicionin e pamundësisë për realizimin e kontratës.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 15:

*Në përputhje me objektin e kontratës dhe rolin e APD-së si autoritet publik dhe zotërues ligjor i sistemit të administrimit financiar, **të gjitha të dhënat financiare dhe operationale që përpunohen përmes JD Edëards janë dhe mbeten pronë e APD-së, nën kontrollin e saj të plotë. Projekti parashikon migrimin/hostimin e infrastrukturës në cloud me qëllim sigurimin e disponueshmërisë, shkallëzueshmërisë dhe sigurisë, por nuk ndryshon titullin e pronësisë mbi të dhënat: operatori ekonomik ofron platformën dhe shërbimin e hostimit dhe nuk fiton asnjë të drejtë dispozitive mbi përmbajtjen.***

Kjo qasje është në vijimësi të praktikës së APD-së me sisteme të tjera të ngjashme të hostuara në cloud. Në këto marrëdhënie, APD-ja mban aksesin e pakufizuar të të dhënave, përcakton politikën e ruajtjes, rezervimeve (backup), rikuperimit dhe arkivimit, si dhe autorizon çdo eksport ose transfer. Operatorit i takon të sigurojë mjedisin, masat e sigurisë dhe reversueshmërinë e shërbimit, por jo të kufizojë përdorimin, eksportin apo migrimin e të dhënave.

Në përfundim të periudhës së shërbimit ose sa herë që kërkohet nga APD, operatori është i detyruar të dorëzojë në mënyrë të plotë të dhënat dhe kopjet rezervë në formate të zakonshme e të dokumentuara (p.sh. dump i bazës së të dhënave, eksporte të skedarëve dhe konfigurimeve), së bashku me udhëzimet e rikthimit dhe metadatat e nevojshme për rindërtim. Dorëzimi duhet të shoqërohet me kontrolle integriteti (p.sh. hash/checksum), listë inventari dhe provë të riprodhueshmërisë në mjedis të APD-së. Gjatë tranzicionit, operatori siguron asistencën e domosdoshme teknike (exit/transition assistance), dritaret e aksesit, personelin kontaktues dhe koordinimin e hapave, në mënyrë që kalimi të jetë i plotë dhe i verifikueshëm.

Pas dorëzimit dhe verifikimit, operatori kryen fshirjen e sigurt të çdo kopjeje që mban në infrastrukturën e tij, sipas një procedure të auditueshme dhe të provueshme me certifikim fshirjeje, duke respektuar njëkohësisht afatet ligjore të ruajtjes së log-eve dhe gjurmëve të auditimit. Çështje si vendndodhja e të dhënave (data residency), enkriptimi në transit dhe në pushim, menaxhimi i çelësave, si dhe qasja e kontrolluar gjatë trajtimit të incidenteve, adresohen në planin e sigurisë dhe në marrëveshjen e nivelit të shërbimit (SLA).

Për këto arsye, nuk ka nevojë të futen specifikime të tjera teknike shtesë në Termat e Referencës lidhur me zotërimin e të dhënave. Pronësia e APD-së është e qartë ligjërisht dhe praktikisht, ndërsa

elementet ekzekutive dhe sanksionuese rregullohen saktë në kontratë/SLA. Pikërisht aty përcaktohen parametrat operacionalë si RTO/RPO, frekuencat e backup-eve, afatet dhe formatet e dorëzimit, të drejtat e auditimit, masat ndëshkuese për mosrespektim dhe përgjegjësitë gjatë fazës së tranzicionit. Mbajtja e TOR-it në nivel kërkesash funksionale dhe jo në detaje operative shmanë kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe siguron fleksibilitet për zgjidhjen më të mirë teknike.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 16

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” në faqe 10 përcaktohet se sistemi i përmirësuar do të duhet të jetë në përputhje me “. Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) duhet të jenë pjesë integrale në sistem, në mënyrë që të lehtësohet dhe automatizohet sa më shumë zbatimi i tyre.”

*Ne dokumentin e specifikimeve teknike **nuk përcaktohet se si AK si zoteruesi i të dhënave të sistemit të administrimit financiar JDE, garantohet që sistemi në platformen cloud do të jetë në përputhje me Rregullore të tjera të sigurisë të nxjerra nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).***

AK do të duhet të përcaktojë specifikimet teknike për sigurinë në përputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)

Kërkesë 16:

AK në dokumentin e specifikimeve, të përcaktojë specifikimet teknike për sigurinë në përputhje me rregullat e Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 16:

Në dokumentin e Termave të Referencës është përcaktuar qartë dhe me qëllim që sistemi i përmirësuar JD Edwards, i cili do të migrohet dhe operojë në mjedis cloud, duhet të jetë në përputhje me çdo rregullore në fuqi dhe me çdo rregullore të re të nxjerrë nga AKSK (jo AKCESK) që lidhet me:

- *sigurinë e informacionit,*
- *parandalimin e cenueshmërisë (vulnerability management),*
- *azhurnimin/patching-un e sistemeve operuese, të bazës së të dhënave dhe aplikacioneve,*
- *autentifikimin, logimin, mbrojtjen ndaj sulmeve, etj.*

Ky formulim i vendos përgjegjësi të drejtpërdrejtë OE-së që zgjidhja teknike e ofruar (infrastruktura cloud dhe sistemi financiar) të jetë gjithmonë e përditësuar dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë që janë në fuqi ose që mund të hyjnë në fuqi gjatë zbatimit të kontratës. Kjo përfshin, ndër të tjera:

aplikimin e rregullt të patch-eve të sigurisë për OS/DB/JDE, aktivizimin e auditimeve, menaxhimin e aksesit të privilegjuar, enkriptimin e të dhënave në transit dhe në pushim, si dhe masa operative për zbulim dhe reagim ndaj incidenteve.

Gjithashtu, zbatimi duhet të jetë në përputhje me Ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo nënkupton respektimin e kërkesave ligjore për menaxhimin e riskut kibernetik, raportimin e incidenteve dhe ruajtjen e gjurmëve të auditimit, brenda afateve dhe formateve të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret e AKSK.

Përvoja ekzistuese me sisteme të tjerë kritikë tregon se zbatimi i kërkesave të AKSK dhe i ligjit realizohet përmes politikave dhe procedurave institucionale të operimit ditor (plan i sigurisë, patch management, incident response, backup/DR, etj.) dhe nuk kërkon specifikime teknike më të detajuara në fazën e prokurimit. Për rrjedhojë, kjo kërkesë trajtohet si sqarim: dokumenti ekzistues e parashikon qartë përputhshmërinë me AKSK dhe me Ligjin nr. 25/2024, dhe çdo OE është i detyruar të ofrojë një zgjidhje që i respekton këto rregulla, për të mos rrezikuar sigurinë kibernetike të sistemit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

ANKESË 17

Ne dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_References.docx” ne faqe 15 përcaktohet se OE do të duhet të kryejë “Kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare”.

Ne dokumentin e specifikimeve teknike nuk ka të përcaktuar nese “log softëare” janë logs te bazes se te dhenave (Oracle Database), janë logs te serverit te aplikimeve(Oracle Eëblogic) apo janë logs te platformes cloud ku do te hostohet sistemi i permiresuar.

Kërkesa e AK e shkruar në mënyrë të përgjithshme, shkakton konfuzion tek OE-te dhe OE-ve, AK mund të kërkojë log-e të tjera të bazes së të dhënave (Oracle Database), të serverit të aplikimeve(Oracle Eëblogic) apo janë logs të platformes cloud, për të paparashikuara që kanë impakt financiar.

Kërkesë 17:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike të gjithë loget softëare që OE duhet të kontrollojë gjatë SLA.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 17:

Qëllimi i këtij detyrimi është që operatori ekonomik (OE) të garantojë monitorim të plotë dhe të vazhdueshëm të sistemit financiar JD Edwards në të gjithë shtresën softëare, për të identifikuar,

parandaluar dhe trajtuar në kohë çdo problem teknik ose të sigurisë. Formulimi “kontroll i detajuar i gjithë log-eve softëare” ka kuptim gjithëpërfshirës dhe mbulon, pa kufizim:

- Application logs:
 - JD Edwards EnterpriseOne logs
 - ËebLogic Server logs
- Database logs:
 - Alert logs
 - Listener logs
 - Audit logs
- Operating system logs: Linux dhe Ëindoës Server, për aq sa ndikojnë funksionimin e JDE
- Cloud infrastructure logs: në masën që ofrohen nga platforma cloud dhe lidhen me performancën/sigurinë e hostimit të sistemit financiar

Kjo nuk shton detyra të reja të paparashikuara; thjesht kërkon që të gjitha komponentët që ndikojnë JDE të jenë nën vëzhgim dhe analizë, si pjesë e shërbimit të mirëmbajtjes dhe të SLA-së. Për zbatim korrekt, OE duhet të sigurojë këto parime operative (pa ndryshuar objektin teknik të kontratës):

- Qendërzim i log-eve në një mjedis të vetëm analitik (p.sh. SIEM/observability), me korrelacion ngjarjesh dhe alarmim sipas pragjeve të dakordësuara në SLA.
- Integritet dhe gjurmueshmëri: time-stamping i saktë (sinkronizim NTP), ruajtje e paprekshme/ e verifikueshme (p.sh. hash), historik auditimi për akseset/veprimet.
- Kontroll i aksesit me role (RBAC) dhe ndarje detyrash; maskim të dhënash, kur është e nevojshme.
- Retention dhe disponueshmëri: ruajtje e log-eve sipas afateve të SLA-së dhe rregulloreve në fuqi; log-et duhet të jenë të kërkueshme dhe të eksportueshme për hetim/raportim incidentesh.

Kjo kërkesë është sqarim, jo ndryshim i specifikimeve: termi “log-e softëare” në dokumentin e specifikimeve teknike tashmë i përfshin këto kategori dhe praktikat përkatëse të administrimit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.”.

III.1.2. Neni 30 i LPP, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se :

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”.

III.1.4. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se objekti i pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, të parashtruara në **Ankesën nr. 3** lidhet me kërkesën për **riargumentimin** e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Shtojcës 9 “**FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të parashtruara në **Ankesën nr. 11** lidhet me kërkesën për për sqarim përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 2.3, të dokumentit “**TERMAT E REFERENCËS**” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të parashtruara në **Ankesën nr. 12**, **Ankesën nr.14** dhe **Ankesën 15** lidhen përkatësisht me kërkesat për sqarim përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 2.1, të dokumentit “**TERMAT E REFERENCËS**” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**” të dokumentave të

tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të parashtruar në **Ankesën nr. 16** lidhet përkatësisht me kërkesën për sqarim përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 4.1.4 të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe të parashtruara në **Ankesën nr. 17** lidhen me kërkesën për sqarim përsa i përket termave të referencës të përcaktuara në Seksionin 8 të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Gjithashtu, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes të ankesës së operatorit ekonomik si më sipër cituam, rezulton, se e ka **riargumentuar** kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe ka sqaruar termat e referencës të përcaktuara përkatësisht në Seksionin 2.1, në Seksionin 2.3 dhe në Seksionin 8 të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Duke qenë, se pretendimet e mësipërme i operatorit ekonomik ankimues janë pranuar nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor referuar shkresës së autoritetit kontraktor shkresën “*Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, pasi gjykon, se vendimi i dhënë nga KSHA është shterues dhe pranues për operatorin ekonomik ankimues për këto pretendime të tij dhe për më tepër nuk ka më objekt ankese.

Autoriteti në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar të publikojë shtojcën e modifikuar, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime dhe sqarime.

Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK, lidhur me përcaktimin e kodit CPV në dokumentat e tenderit objekt ankimi, si në vijim: “... **Duke qenë se objekti i prokurimit është: “Upgrade Oracle JDE” AK do të duhet të shtonte edhe Kodet FPP në DST si më poshtë: Sisteme informacioni dhe servera 48800000-6 Sisteme informacioni 48810000-9 Paketa softëare dhe sisteme informacioni 48000000-8 Sisteme operative 48620000-01 Menaxhim i të dhënave elektronike (edm) 48613000-8 Sistem llogaritje 48444000-2 Shërbim konsulence për rikthim të të dhënave si pasojë e problemeve të 72120000-2 paisjeve kompjuterike Shërbimet e inspektimit strategjik të sistemeve ose teknologjive të 72222100-8 informacionit Shërbimet e konsulencës në sisteme informatike dhe asistencë teknike 72220000-3 Shërbimet e konsulencës për**

testimin e pranueshmërisë së softëarit të 72226000-5 sistemit Shërbimet e konsulencës së integritit të softëareve 72227000-2 Testimi i softëareve 2254000-0 Shërbimet e testimit të softëareve 72254100-1 Shërbimet e lidhura me softëaret 72260000-5 Shërbimet e asistencës softëare 722610 Shërbimet e implementimit të softëareve 72263000-6 Shërbimet e konfigurimit të softëareve 72265000-0 Shërbimet e konsulencës së softëareve 72266000-7 Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve 72267000-4 Riparimi i softëareve të teknologjisë së informacionit 72267200-1 Shërbimet e furnizimit të softëareve 72268000-1 Shërbimet e të dhënave 72300000-8 Shërbimet e përpunimit të të dhënave 72310000-1 Shërbimet e zhvillimit të softëareve it 72212517-6 Shërbime per krijim programesh per menaxhim te marrëdhënieve me klientët 72212445-0 Sa më lart kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor:

Kërkesa 1.1:

Përcaktimin e kodeve FPP të saktë relevant me këtë procedurë prokurimi, sipas parashikimeve ligjore.

Kërkesa 1.2:

KPP të detyrojë AK mbi këtë të fundit pasi kjo ngushtësisht kufizon operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe dëmton konkurrencën., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.2.1. Në Seksionin 2 “Objekti i kontratës” pika 2.2 “**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)**” të dokumentave të tenderit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) :

- Shërbimet e teknologjisë së informacionit – 72222300-0;
- Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit – 72267100-0.

III.2.2. Në shtojcën 7 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar lloji, sasitë dhe afati i ekzekutimit të shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Krijimi i Infrastruktues Cloud për Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE</i>	<i>1</i>
<i>2</i>	<i>Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe EëbLogic të azhurnuar</i>	<i>1</i>
<i>3</i>	<i>Mirembajtje 1 (nje) vit i Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE duke përfshirë dhe Infrastrukturen Cloud</i>	<i>1</i>

<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i fazës / Periudha kohore</i>	<i>M1</i>	<i>M2</i>	<i>M3</i>	<i>M4</i>	<i>M5</i>	<i>M6</i>	<i>M7 – M19</i>
<i>1</i>	<i>Faza Përgatitore për përmirësimin e sistemin softëare</i>	X						
<i>2</i>	<i>Konfigurimi i Infrastrukturës Cloud</i>		X	X				
<i>3</i>	<i>Faza e përmirësimi të sistemit softëare</i>				X			
<i>4</i>	<i>Faza e integritit dhe testimit të sistemit softëare</i>					X		
<i>5</i>	<i>Marrja në dorëzim</i>						X	
<i>6</i>	<i>Fillimi i procesit të mirëmbajtjes</i>							X

Afatet e ekzekutimit:

AFATI I EKZEKUTIMIT: 6 (gjashtë) muaj nga lidhja e kontrates

(Operatori Ekonomik Fitues do të kryejë Mirembajtje (1 vit) nga momenti i marrjes në dorëzim të projektit)

Referohuni dokumentacionit ngarkuar në SPE me emërtimin 2_“Termet e References

III.2.3. Në Seksionin 1 “Hyrje” dhe Seksionin 2.1 “OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA” të dokumentit “TERMAT E REFERENCËS” të Shtojcës 8 “FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar natyra e shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Përfituesi: Autoriteti Portual Durrës

Autoriteti Kontraktues: Autoriteti Portual Durrës

1.2. Historiku

Sistemi i menaxhimit financiar i Autoritetit Portual Durrës bazuar ne teknologjine Oracle JD Edëards EnterpriseOne është implementuar mbi 10 vite më parë. Në atë kohë, sistemi Sistemi i menaxhimit financiar ka qenë një përfitim strategjik në aspektin operacional, financiar dhe teknologjik për Autoritetin Portual Durrës:

1. Eficienca Operacionale

- *Automatizoi dhe përmirësoi proceset thelbësore financiare si Libri i Madh, të Inventarizimin, Ardhurat dhe të Detyrimet.*

2. Saktësia Financiare

- *Ka siguruar validimin e qëndrueshëm të të dhënave dhe gjurmueshmëri për të gjitha transaksionet financiare.*
- *Ka përmirësuar pajtueshmërinë me standardet kontabël përmes kontrollimeve dhe raporteve të integruara.*
- *Ka minimizuar gabimet dhe mospërputhjet duke qendruar si burimi i vetëm dhe i vërtetë i të dhënave financiare.*

Në tërësi, Sistemi i menaxhimit financiar (JD Edëards EnterpriseOne version aktual 9.1) ofron një platformë të unifikuar financiare që përmirëson transparencën, përshpejton vendimmarrjen dhe mbështet rritjen e qëndrueshme.

Me kalimin e viteve, sistemi ka pësuar një përkeqësim të ndjeshëm, veçanërisht në aspektin e sigurisë. Kjo jo vetëm që po ndikon në besueshmërinë e sistemit të menaxhimit financiar të vetë Portit të Durrësit, por gjithashtu po kufizon potencialin për përmirësime të ardhshme.

Autoriteti Portual Durrës, si pasojë e sfidave aktuale me të cilat përballet sistemi i menaxhimit financiar, synon një përmirësim gjithëpërfshirës të sistemit ekzistues përmes versionit të fundit duke thjeshtuar kështu procesin. Qëllimi ynë është të tregojmë se si modernizimi i këtij sistemi në çdo

komponent të tij jo vetëm që do të rivendosë funksionalitetin e plotë të sistemit, por edhe do ta pozicionojë atë për rritje dhe inovacion në të ardhmen.

1.3. Situata Aktuale

Sistemi i administrimit financiar JDE (Oracle JD Edwards EnterpriseOne) është një pakete gjithëpërfshirëse për menaxhimin financiar në APD, i cili ofron mjete për:

- a) Administrimin e procesit të kontabilizimit të brendshëm - moduli i Librit të Madh;*
- b) Mbajtjen e librave të magazinës administrative si dhe të furnitoreve - moduli i Inventarit;*
- c) Administrimin e aktiveve të qëndrueshme - moduli i Aseteve Fikse;*
- d) Mbajtjen e librave të shitjeve si dhe të klientëve - moduli i të Arketueshmeve;*
- e) Regjistrimin dhe ndjekjen e pagesave dhe marrëdhënive me bankat - moduli i të Pagueshmeve;*
- f) Administrimin, regjistrimin si dhe matjen e performances së qendrave të ndryshme të kostos (dhe të të ardhurave) të autoritetit portual;*

Sistemi i administrimit financiar JDE është i integruar me sistemet e tjera të APD-së si: sistemi Mainsaver, Payroll etj.

Sistemi i administrimit financiar mbështetet gjithashtu me teknologjinë e avancuar të administrimit, të përpunimit, të mbledhjes dhe të konsolidimit si dhe të paraqitjes e raportimit të informacionit - Oracle Busines Intelligence.

Application 9.1

Tools: 9.1.3.1

ËLS: 10.3.5

Infrastruktura fizike përbëhet nga serverat e listuar, si në tabelën e mëposhtme:

<i>Përshkrimi</i>	<i>Sasia</i>
<i>Infrastruktura është e përbërë nga servera fizike Dell PoëerEdge R760 Server (2*Intel Xeon Gold 6526Y 2.8G, 16C/32T / 512GB RAM / 2*480GB SSD Raid 1 drives) të cilët shërbejnë për ndertimin e një cluster tradicional bazuar në softëare të virtualizimit Vmëare. Serverat janë të lidhur me një storage enterprise në të cilin ruhen dhe procesohen makinat virtuale egzistuese.</i>	<i>3</i>

<i>Emri</i>	<i>Roli</i>	<i>Kujtesa (RAM)</i>	<i>PN</i>	<i>Procesori (CPU)</i>	<i>Kujtesa e Jashtme (HDD)</i>	<i>Sistemi Operativ</i>	<i>Komente</i>
<i>Server Dell PoëerEdge R760 #1</i>	<i>Makina fizike - ne te cilen eshte instaluar hypervisorine te cilen mban makinat virtuale VM</i>						<i>Në këtë infrastrukturë fizike të virtualizuar ndodhet makina virtuale VM "JDEDEP" e cila ka rolin e serverit të aplikacionit për sistemin financiar të Autoritetit Portual Durrës</i>
<i>Server Dell PoëerEdge R760 #2</i>	<i>Makina fizike - ne te cilen eshte instaluar hypervisorine te cilen mban makinat virtuale VM</i>						<i>Në këtë infrastrukturë fizike të virtualizuar ndodhet makina virtuale VM - JDEDEP e cila ka rolin e serverit të bazës së të dhënave për sistemin financiar të Autoritetit Portual</i>


							<i>Durrës</i>
<i>Server Dell PoëerEdge R760 #3</i>	<i>Makina fizike - ne te cilen eshte instaluar hypervisor ne te cilen mban makinat virtuale VM</i>						<i>Në këtë infrastrukturë fizike të virtualizuar ndodhet sherben si makine reserve per te hostuar makinat virtuale VM "JDEDEP" dhe "JDEENT" ne rast deshtimi te nje nga makinave fizike qe mbajne sherbimet aktualisht</i>

Infrastruktura virtuale e sistemit të administrimit financiar JDE përbëhet nga serverat e listuar, si në tabelën e mëposhtme:

<i>Server Name</i>	<i>Përshkrim</i>	<i>Sistemi Operativ</i>	<i>Disk</i>	<i>RAM MAX</i>	<i>CPU MAX</i>	<i>Netëork speed MAX</i>
<i>JDE_Deployment</i>	<i>Server i sistemit</i>	<i>Ëindoës server</i>	<i>C:\ (80 GB), D:\</i>	<i>20 GB</i>	<i>6 vCPU</i>	<i>1 GBps</i>

JDEDEP	<i>financiar</i>	<i>2008 R2</i>	<i>(200GB)</i>			
JDE_Neë JDEENT	<i>Databaza e sistemit financiar</i>	<i>Red Hat Linux 6 (64 Bit)</i>	<i>/ (20 GB), /u01 (1.7TB)</i>	<i>20 GB</i>	<i>8 vCPU</i>	<i>1 GBps</i>

➤ **Digrama e sistemit aktual Oracle JD Edëards**



➤ **Baza e të Dhënave Oracle JDE**

Kategoria	Përshkrimi
<i>Tipi i Database-s</i>	<i>Oracle Database</i>
<i>Versioni</i>	<i>11g (11.2.0.1.0) Enterprise Edition</i>

- **Parametrat**

<i>Parametri</i>	<i>Vlerat</i>
<i>NLS_LANGUAGE</i>	<i>AMERICAN</i>
<i>NLS_CHARACTERSET</i>	<i>ËE8MSËIN1252</i>
<i>NLS_SORT</i>	<i>BINARY</i>
<i>NLS_COMP</i>	<i>BINARY</i>
<i>NLS_LENGTH_SEMANTICS</i>	<i>BYTE</i>
<i>NLS_NCHARCONV_EXCP</i>	<i>FALSE</i>
<i>NLS_NCHARACTER_SE T</i>	<i>AL16UTF16</i>

- **Serveri i Aplikacionit Oracle JD Edëards**

- **Informacioni i Versionit**

<i>Kategoria</i>	<i>Përshkrimi</i>
<i>Version</i>	<i>JD Edëards 9.1</i>
<i>Tools Release</i>	<i>9.1.3.1</i>
<i>Bitness</i>	<i>32 bits</i>
<i>Oracle Certified</i>	<i>Yes</i>
<i>Oracle PoC Applied</i>	<i>No</i>
<i>Server Manager version</i>	<i>9.1.2.4</i>
<i>Server Manager Agent Version</i>	<i>9.1.2.4</i>
<i>Application Server Version</i>	<i>ËebLogic 11g</i>
<i>Application Server Java Version</i>	<i>28.1.3.-4.0</i>

- **Përmbledhje mbi konfigurimin JD Edëards**

<i>Kategoria</i>	<i>Përshkrimi</i>
<i>Languages installed</i>	<i>English (Default)</i>
<i>Media Objects storage, usage</i>	<i>Default filesystem (P98MOQUE)</i>
<i>Authentication Method</i>	<i>Standard JD Edwards Security</i>
<i>Active User count</i>	<i>82 defined users (Active) in the system</i>
<i>Proxy user config</i>	<i>All Users use JDE as proxy (database user)</i>
<i>Job Scheduler</i>	<i>Standard JD Edwards job scheduler</i>
<i>Purge UBE Retention</i>	<i>Non-discovered</i>
<i>One Vieë Reporting</i>	<i>Not Used</i>

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është:

- Migrimin i infrastkutures së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud.
- Permiresim i sistemit sistemi i administrimit financiar Oracle JDE (Oracle JD Edwards EnterpriseOne 9.1 ne 9.2) dhe përditësim i tij nga Oracle JD Edwards EnterpriseOne 9.1 ne sistemin e permiresuar Oracle JD Edwards EnterpriseOne 9.2 duhet perfshire permiresimin e komponentet **Oracle JD Edwards Tools** dhe **Oracle EëbLogic Server** në versionin më i fundit të disponueshëm nga Oracle për Tools Release. Sistemi i përditësuar duhet të jetë “code current” (me datë - data e fillimit të projektit) ku modifikimet/përshtatjet e përzgjedhura/konfirmuara të transferohen ne sistemin e ri.Gjithashtu sistemi i perditësuar duhet të jetë në përputhje me (Minimum Technical Requirements)-të e Oracle për JD Edwards.
- Permiresim i bazes se te dhenave nga **Oracle Database Enterprise Edition 11g** ne minimumi Oracle Database 19c.

- *Migrimi i te dhenave.*
- *Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e aplikacionit nga Eëindoës server 2008 R2 (64 bit) ne Eëindoës Server 2019 ose me lart.*
- *Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e bazes se te dhenave nga Red Hat Linux ne min, Oracle Linux 8.10.*
- *Migrimin i sistemit të sistemi të administrimit financiar ne Platformen Cloud*

III.2.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” parashikohet:

“FJALORI I PËRBASHKËT I PROKURIMIT

LISTA E KODEVE CPV

Shpjegime dhe përshkrime: Fjalori i Përbashkët i Prokurimit është i bazuar në një strukturë bazë, që përfshin kode deri në nëntë shifra, të shoqëruara me një formulim që përshkruan mallrat, punët ose shërbimet, të cilat janë objekt i një procedure prokurimi. Në çdo rast, për zhvillimin e një procedure prokurimi, autoritetet ose entet kontraktore duhet të përzgjedhin detyruesisht në sistemin e prokurimit elektronik një prej kodeve të përcaktuara që i korrespondon objektit konkret të prokurimit. Kodi numerik përbëhet nga 9 shifra, të ndara si më poshtë: - dy shifrat e para identifikojnë ndarjet (XX000000-Y); - tri shifrat e para identifikojnë grupet (XXX00000-Y); - katër shifrat e para identifikojnë klasat (XXXX0000-Y); - pesë shifrat e para identifikojnë kategoritë (XXXXX000-Y). Secila prej tri shifrave të fundit ofron një shkallë më të madhe saktësie brenda secilës kategori. Shifra e nëntë shërben për të verifikuar shifrat e mëparshme

KODI CPV EMËRTIMI I KODIT CPV

72222300-0 - Shërbimet e teknologjisë së informacionit;

72267100-0 - Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit

III.2.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit dhe konkretisht i pikës 2.2 2.2 “**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP)**” të dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka publikuar dy kode CPV, si në vijim: “72222300-0 - Shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe 72267100-0 - Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit.”, ndërkohë referuar shtojcës 7 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar shërbimet objekt prokurimi, si në vijim:

“Krijimi i Infstruktures Cloud për Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE; Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe EëbLogic të azhurnuar dhe Mirembajtje 1 (nje) vit i Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE duke përfshirë dhe Infrastrukturen Cloud.”, ndërsa në Seksionin 1 *“Hyrje”* dhe Seksionin 2.1 *“OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA”* të dokumentit *“TERMAT E REFERENCËS”* të Shtojcës 8 *“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”* të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar natyrën e shërbimeve objekt prokurimi, ku konstatohet se objekti i prokurimit është përmirësimi i programit softëerik *“Oracle JD Edëards EnterpriseOne”*, i cili përfshim migrimin, përmirësimin e këtij programi.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 457, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit”* janë dhënë shpjegime dhe përskrime për kodet që përban Fjalori i Përbashkët i prokurimit, ku përcaktohet se autoritetet kontraktore duhet të përzgjedhin në sistemin e prokurimit elektronik njërin prej kodeve që i korespondojnë objektit të prokurimit., Lidhur me pretendimet e mësipërme të ankimuesit, Komisioni gjykon se nuk qëndrojnë, pasi referuar natyrës së shërbimeve objekt prokurimi të përcaktuara në Seksionin 1 *“Hyrje”* dhe Seksionin 2.1 *“OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA”* të dokumentit *“TERMAT E REFERENCËS”* të Shtojcës 8 *“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”* të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur kodet që i korespondojnë shërbimeve objekt prokurimi, si më sipër përmendur.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Advanced Business Solutions - ABS”* SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Advanced Business Solutions - ABS”* SHPK, lidhur me vendosjen e termit *“Ekuivalent”* në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 *“Kapaciteti teknik”* të Shtojcës 9 *“FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT”* të dokumentave të tenderit objekt ankimi, si në vijim:

ANKESË 4

b) Të paktën 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator.

Sa i perket kriterit të mesipërme kërkojme shtimin “Ose ekuivalent” në përputhje me pikën 4 të Nenit 36 të LPP, AK duhet të shtojë dhe ekuivalencën, pasi mosparashikimi i ekuivalencës sjell diskriminim dhe c'orienton OE.

Kërkese 4:

Të shtohet “ose ekuivalent” në kriterin: “b)Të paktën 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator”.

ANKESË 5

c) Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator)

Sa i perket kriterit të mesiperm kërkojme shtimin “Ose ekuivalent” në përputhje me pikën 4 të Nenit 36 të LPP, AK duhet të shtojë dhe ekuivalencën, pasi mosparashikimi i ekuivalencës sjell diskriminim dhe c'orienton OE.

Kërkesë 5:

Të shtohet “ose ekuivalent” në kriterin: “b) Të paktën 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator”.

ANKESË 6

Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator).

Sa i perket kriterit të mesiperm kërkojme shtimin “Ose ekuivalent” Në përputhje me pikën 4 të Nenit 36 të LPP, AK duhet të shtojë dhe ekuivalencën, pasi mosparashikimi i ekuivalencës sjell diskriminim dhe c'orienton OE.

Kërkesë 6:

Të shtohet “ose ekuivalent” në kriterin:

Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator).

ANKESË 7

Të paktën 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt. Sa i perket kriterit të mesiperm kërkojme shtimin “Ose ekuivalent” në përputhje me pikën 4 të Nenit 36 të LPP, AK duhet të shtojë dhe ekuivalencën, pasi mosparashikimi i ekuivalencës sjell diskriminim dhe c'orienton OE.

Kërkesë 7:

Të shtohet “ose ekuivalent” në kriterin:

“Të paktën 3 (tre) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt”.

ANKESË 8

Të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhuesi për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional.

Sa i perket kriterit të mesiperm kërkojmë shtimin “Ose ekuivalent” në përputhje me pikën 4 të Nenit 36 të LPP, AK duhet të shtojë dhe ekuivalencën, pasi mosparashikimi i ekuivalencës sjell diskriminim dhe c'orienton OE.

Kërkesë 8:

Të shtohet “ose ekuivalent” në kriterin:

Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.3.1. Në shtojcën 9 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “*Kapacitetin teknik*”, të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

2.3.5 *Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:*

- a) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.*
- b) ***Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator. (ANKESA 4)***
- c) ***Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator) (ANKESA 5)***
- d) ***Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator). (ANKESA 6)***
- e) ***Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt. (ANKESA 7)***
- f) ***Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional. (ANKESA 8)***
- g) *Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar si programues. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent*
- gj) *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus në modulin "General Ledger" (Libri Kryesor/i Madh). Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle Microsoft ose ekuivalent.*
- h) *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar si specialist implementimi për menaxhim financiar, me fokus në modulin "Payables" (Të Pagueshmet). Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent.*
- i) *Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar si "Implementation Specialist" për pajisjet Storage. Certifikimet/Transkriptet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Oracle, Microsoft ose ekuivalent.*
- j) *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar si Arkitekt për Sigurinë Kibernetike (Cybersecurity Architect), në nivelin Ekspert. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Cisco, Juniper ose ekuivalent.*
- k) *Të paktën 1 (një) punonjës i certifikuar në nivelin Netëork Associate dhe si Specialist për Security Core. Certifikimet duhet të jenë të lëshuara nga prodhues të njohur si Cisco, Juniper etj.*

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

III.3.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues dhe konkretisht të kualifikimeve profesionale të sipërpërmendura në ankesë, si më poshtë vijon:

“2.3.5 Për të vërtetuar aftësitë dhe kapacitetet teknike të punonjësve, operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij:

b) Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator.

Argumentimi: Kjo kontratë ka për qëllim instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin (update/patching) të sistemeve operative (OS) në kuadër të infrastrukturës virtuale të ngritur në mjedisin “Cloud”, për serverët e bazës së të dhënave (Database Server VM), serverët e aplikacionit (Application Server VM), si dhe mjediset e zhvillimit (Development Server/Client VM).

Për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të kësaj infrastrukture, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në Sistemet Operative (OS), në nivelin Associate ose System Administrator.

Këta specialistë duhet të jenë në gjendje të:

- Kryejnë instalimin dhe konfigurimin profesional të sistemeve operative për secilën nga makinat virtuale të projektit,
- Aplikojnë në mënyrë të saktë patch-et dhe përditësimet e sigurisë të rekomanduara nga prodhuesi i OS,
- Monitorojnë dhe mirëmbajnë performancën dhe disponueshmërinë e mjedisit operativ,
- Reagojnë në kohë ndaj problemeve dhe ngarkesave në sistemin operativ për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit të aplikacioneve dhe bazës së të dhënave.

Prania e personelit të certifikuar është një garanci për zbatim korrekt, sipas praktikave më të mira të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe performancës, duke përmbushur në mënyrë të plotë kërkesat funksionale dhe teknike të këtij projekti.

c) Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator)

Argumentimi: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës. Për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar si Administrator Databaze dhe si zhvillues në bazat e të dhënave (database) për të në përmirësimin e efikasitetit dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të bazës së të dhënave gjatë gjithë jetës së projektit.

Kjo kontratë ka për qëllim instalimin, konfigurimin dhe administrimin e bazës së të dhënave për sistemin financiar të Autoritetit Portual Durrës. Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë personel të specializuar dhe të certifikuar në administrimin dhe zhvillimin e bazave të të dhënave.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të ketë minimumi 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi si Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA Instalimi dhe konfigurimi i databazës të kryhet sipas standardeve të prodhuesit, duke garantuar performancë të lartë dhe siguri,

- Zhvillimet specifike në nivelin e databazës (p.sh. procedura të ruajtura, triggerë, optimizim queriesh) të kryhen nga një zhvillues i kualifikuar, për të përmbushur nevoja të personalizuar të projektit,
- Të sigurohet qëndrueshmëri dhe efikasitet i lartë operacional i databazës gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit, përfshirë mirëmbajtjen, përditësimet dhe menaxhimin e performancë

Ky kriter është vendosur për të garantuar cilësi të lartë teknike dhe mbulim të plotë të të gjitha aspekteve të menaxhimit të bazës së të dhënave, që është një komponent kritik për funksionimin korrekt të sistemit financiar të projektuar.

d) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator).

Argumentim: Në mënyrë që kërkesat funksionale dhe teknike të përmbushen sipas kushteve të kontratës, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë personel të kualifikuar dhe të certifikuar në fushën e infrastrukturës së bazës së të dhënave. Për këtë arsye është kërkuar që të paktën 2 (dy) punonjës të jenë të certifikuar për “Database Infrastructure”.

Ky kriter është vendosur pasi projekti parashikon instalimin, përditësimin dhe migrimin e bazës së të dhënave ne Cloud si dhe të elementeve kritikë të saj, siç janë Grid Infrastructure dhe Automatic

Storage Management (ASM). Këto komponentë janë thelbësorë për ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe me disponueshmëri të lartë (high availability).

Për të garantuar zbatimin e duhur të këtyre proceseve, si dhe për të siguruar që funksionalitetet e kërkuara nga projekti të implementohen në mënyrë të saktë, është e domosdoshme që operatori të ketë në dispozicion specialistë të certifikuar dhe me ekspertizë konkrete në administrimin e infrastrukturës së bazës së të dhënave. Kjo siguron jo vetëm implementim të saktë, por edhe mbështetje të qëndrueshme dhe të sigurt për sistemin gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit.

e) Të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim migrimin e sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës "Oracle JDE" drejt një infrastrukture Cloud. Procesi përfshin jo vetëm transferimin teknik të të dhënave dhe aplikacioneve, por gjithashtu kërkon projektim, konfigurim, optimizim dhe sigurim të një arkitekture Cloud të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe të sigurt.

Për këtë arsye, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë të paktën 3 (tre) punonjës të certifikuar në nivelin "Cloud Infrastructure Architect" nga prodhuesi i zgjidhjes Cloud. Certifikimi në nivel Arkitekt siguron që personeli të ketë aftësitë teknike dhe konceptuale për të projektuar një infrastrukturë Cloud që i përshatet kërkesave specifike të sistemit financiar, përfshirë:

- *Hartimin e arkitekturës së përgjithshme Cloud (compute, storage, netëorking, security),*
- *Zgjedhjen dhe konfigurimin e shërbimeve Cloud të duhura për performancë dhe efikasitet,*
- *Sigurimin e integritetit të suksesshëm me sistemet ekzistuese,*
- *Garantimin e vazhdimësisë së shërbimit,*
- *Përdorimin e praktikave më të mira për sigurinë dhe pajtueshmërinë.*

Përfshirja e ekspertëve të certifikuar në këtë nivel është një garanci e drejtpërdrejtë për zbatimin korrekt dhe të suksesshëm të projektit, si dhe për sigurimin që funksionalitetet e kërkuara nga kontrata të realizohen me profesionalizëm të lartë dhe brenda standardeve ndërkombëtare të teknologjisë Cloud.

f) Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional.

Argumentim: Ky projekt ka për qëllim migrimin e bazës së të dhënave të sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës drejt një infrastrukture Cloud, një proces teknikisht kompleks që kërkon planifikim të kujdesshëm, analiza të thelluara të strukturës ekzistuese të të dhënave, si dhe zbatim pa ndikuar në vazhdimësinë e shërbimit.

Për të garantuar që ky proces të realizohet në mënyrë të saktë, të sigurt dhe pa humbje të të dhënave, është thelbësore që operatori ekonomik të disponojë të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar në nivelin "Professional" për Cloud Database Migration nga prodhuesi i zgjidhjes Cloud.

Certifikimi profesional siguron që personeli ka:

- *Njohuri të thelluara për metodologjitë e migrimit të bazave të të dhënave drejt Cloud,*
- *Eksperiencë në përdorimin e mjeteve dhe shërbimeve zyrtare për migrim të automatizuar dhe të kontrolluar,*
- *Aftësi për të menaxhuar riskun gjatë migrimit dhe për të ndjekur praktikatat më të mira për siguri, performancë dhe integritet të të dhënave,*
- *Eksperiencë në testimin, validimin dhe optimizimin e bazës së të dhënave pas migrimit në ambientin Cloud.*

Përfshirja e stafit të certifikuar në këtë proces është një parakusht për të garantuar zbatimin korrekt të projektit, si dhe për të siguruar që funksionalitetet kritike të sistemit financiar të mos ndërpriten dhe të përmirësohen në përputhje me kapacitetet që ofron infrastruktura Cloud.”.

III.3.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” ShPK autoriteti kontraktor me shkresën *Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, i ka shqyrtuar këto pretendime të ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon

“PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 4:

Objekti i procedurës lidhet me upgrade-in e një sistemi kritik, i cili përfshin ndërhyrje në nivelet më të ndjeshme të infrastrukturës së IT-së, si konfigurimi i kernel-it, menaxhimi i proceseve, optimizimi i resurseve dhe siguria e aksesit në mjedisin operativ. Këto procese kërkojnë njohuri të certifikuar drejtpërdrejt nga prodhuesi i sistemit operativ, pasi vetëm këto certifikime garantojnë trajnim dhe testim mbi praktikatat zyrtare të mirëmbajtjes dhe sigurisë. Në rastet e upgrade-ve të sistemeve kritike, edhe një gabim minimal në konfigurim ose në menaxhimin e proceseve të sistemit operativ mund të sjellë ndërprerje të shërbimeve, humbje të integritetit të të dhënave ose dobësi të rënda sigurie.

Për këtë arsye, kërkesa për certifikim nga prodhuesi nuk është kufizuese, por një masë mbrojtëse për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve dhe funksionimin korrekt të sistemit. Përdorimi i termit “ekuivalentë” nuk ka një standard të unifikuar dhe të verifikueshëm. Certifikimet e lëshuara nga subjekte të tretë nuk garantojnë që trajnimet e dhëna mbulojnë të gjitha funksionalitetet kritike, si menaxhimi i patch-eve të sigurisë, integrimi me sisteme të tjera ose konfigurimi i rolit të administratorit. Për pasojë, kjo do të sillte pasiguri teknike dhe vështirësi objektive në procesin e

vlerësimin të ofertave. Neni 36, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon mundësinë që autoriteti kontraktor të kërkojë certifikata profesionale të posaçme si provë për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik. Kjo dispozitë i jep autoritetit kontraktor të drejtën të përcaktojë kriteret e sakta të certifikimit në përputhje me natyrën e kontratës.

Po i njëjti nen lejon që, në raste të tjera, operatorët ekonomikë të provojnë kapacitetin përmes dokumentacionit alternativ, por kjo nuk është detyrim absolut për autoritetin kontraktor. Nëse objekti i kontratës ka natyrë të tillë që kërkon certifikim strikt dhe unik, autoriteti kontraktor ka të drejtë të mos parashikojë ekuivalencë, nëse kjo do të çenonte standardet e sigurisë dhe besueshmërisë së kontratës.

Për më tepër, parimi i proporcionalitetit dhe i mosdiskriminimit, i përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, nuk cenohet, pasi kriteri zbatohet njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë. Ai nuk kufizon pjesëmarrjen në mënyrë të padrejtë, por lidhet ngushtë me objektin e kontratës dhe me garancinë që vetëm certifikimet e prodhuesit ofrojnë nivelin e kërkuar të ekspertizës.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 5:

Objekti i procedurës lidhet me upgrade-in e një sistemi kritik të informacionit, ku baza e të dhënave është komponenti themelor për ruajtjen, përpunimin dhe integritetin e informacionit. Menaxhimi i bazës së të dhënave përfshin procese të ndjeshme si backup & recovery, tuning i performancës, konfigurimi i shërbimeve të replikimit, enkriptimi dhe kontrollat e aksesit. Gabime apo mungesë njohurish të sakta në këto fusha mund të rezultojnë në humbje të pakthyeshme të të dhënave, ndalje

të shërbimeve ose dobësi kritike të sigurisë. Vetëm certifikimet e lëshuara nga prodhuesi i bazës së të dhënave garantojnë që personeli ka njohuritë praktike mbi standardet dhe mjetet zyrtare për administrimin e versioneve dhe moduleve specifike që do të përdoren në këtë procedurë. Certifikatat e ofruara nga subjekte të tjera nuk mbulojnë domosdoshmërisht të gjitha funksionalitetet e plota të platformës dhe nuk sigurojnë kompatibilitet në nivelin që kërkohet.

Përdorimi i termit të përgjithshëm “ose ekuivalentë” në këtë rast do të krijonte paqartësi dhe hapësirë për subjektivizëm në vlerësimin e ofertave, pasi nuk ekziston një standard i njohur ndërkombëtarisht që përcakton ekuivalencën e certifikimeve të ndryshme për administratorët e bazës së të dhënave. Kjo do të çenonte objektivitetin e procesit dhe do të rrezikonte besueshmërinë e rezultatit të tenderit.

Neni 36, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” autorizon autoritetin kontraktor të kërkojë certifikata specifike profesionale si provë të kapacitetit teknik dhe profesional. Ky nen parashikon gjithashtu mundësinë e përdorimit të dokumenteve të tjera të barasvlershme, por kjo nuk

është një detyrim absolut për autoritetin kontraktor; është në kompetencën e tij të vendosë kur kërkohet certifikim strikt dhe unik për të garantuar realizimin e suksesshëm të kontratës.

Në këtë rast, duke qenë se baza e të dhënave është komponenti më kritik i sistemit, kërkesa për certifikim të drejtpërdrejtë nga prodhuesi është proporcionalisht e justifikuar. Ajo nuk vendos diskriminim të padrejtë, pasi zbatohet njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë dhe është lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës. Parimi i mosdiskriminimit dhe i proporcionalitetit I parashikuar në nenin 7 të LPP-së respektohet, pasi kriteri është i domosdoshëm për të siguruar integritetin, sigurinë dhe cilësinë e administrimit të bazës së të dhënave në kuadër të kësaj procedure.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 6:

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me administrimin e infrastrukturës së bazës së të dhënave në nivel të avancuar, duke përfshirë komponentë kritikë si Real Application Clusters (RAC), Automatic Storage Management (ASM) dhe Grid Infrastructure. Këto module janë themelore për garantimin e redundancës, performancës dhe qëndrueshmërisë së mjedisit të bazës së të dhënave. Menaxhimi i këtyre moduleve kërkon njohuri shumë specifike mbi konfigurimin e klasterëve, balancimin e ngarkesës, menaxhimin e storage-it, rikuperimin pas dështimeve dhe sigurinë e aksesit. Vetëm certifikimet e lëshuara nga prodhuesi sigurojnë që personeli i operatorit ekonomik zotëron këto aftësi në përputhje me praktikat dhe standardet zyrtare. Përfshirja e termit “ose ekuivalentë” do të sillte paqartësi teknike dhe vështirësi në vlerësimin e ofertave, pasi nuk ekziston një mekanizëm objektiv që të përcaktojë barasvlerësinë e trajnimeve ose certifikimeve të dhëna nga subjekte të tretë në këto fusha kaq të specializuara. Kjo do të krijonte rrezik për subjektivizëm, duke çenuar integritetin e procedurës.

Neni 36, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i jep autoritetit kontraktor kompetencën të kërkojë certifikata të posaçme profesionale si provë të kapacitetit teknik dhe profesional. Ky nen nuk e detyron autoritetin të pranojë “ekuivalencë” kur natyra e kontratës kërkon standarde të veçanta sigurie dhe besueshmërie. Në këtë rast, kërkesa për certifikim nga prodhuesi është proporcionale dhe e justifikuar, pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik të angazhojë staf me kompetenca të verifikueshme në teknologjinë e specifikuar. Parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit të parashikuara në nenin 7 të LPP-së respektohen, pasi kriteri zbatohet njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë. Ai nuk kufizon konkurrencën, por siguron që vetëm operatorët me staf realisht të kualifikuar për infrastrukturën e bazës së të dhënave të marrin pjesë, duke shmangur riskun për dështim teknik në fazën e ekzekutimit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 7:

Ky kriter lidhet me projektimin dhe administrimin e infrastrukturës Cloud, në nivel Arkitekt, që përfshin elementë kritikë si: orkestrimi i resurseve, siguria e multi-tenantëve, integrimi i shërbimeve të rrjetit dhe storage, balancimi i ngarkesës dhe konfigurimi i politikave të backup & disaster recovery. Këto janë funksione thelbësore për garantimin e shkallëzueshmërisë, performancës dhe sigurisë së sistemit që do të përditësohet.

Për shkak të natyrës së kontratës (upgrade i një sistemi kritik), kërkohet që personeli i angazhuar të zotërojë certifikime zyrtare të nivelit Arkitekt të lëshuara nga prodhuesi i platformës Cloud. Vetëm këto certifikime ofrojnë siguri se arkitektura e ndërtuar do të jetë në përputhje me standardet teknike dhe politikat e sigurisë të platformës. Përfshirja e termit “ose ekuivalentë” në këtë rast do të krijonte pasiguri teknike dhe vështirësi objektive në vlerësim, pasi certifikatat e dhëna nga subjekte të tretë nuk garantojnë njohuri të plota mbi konfigurimin vendor, mbi përdorimin e mjeteve specifike të orkestrimit dhe mbi praktikat zyrtare të migrimit dhe mirëmbajtjes së resurseve Cloud.

Çdo devijim në këtë nivel teknik (arkitekturë Cloud) do të sillte rrezik serioz për mosfunksionim të sistemit, humbje të integritetit të të dhënave ose ekspozim ndaj dobësive të sigurisë kibernetike. Neni 36, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikime profesionale të posaçme si provë të kapacitetit teknik. Ky nen nuk e detyron autoritetin të parashikojë ekuivalencë kur natyra e kontratës dhe rreziku teknik kërkojnë standarde specifike të certifikuara vetëm nga prodhuesi. Parimet e mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit të parashikuara në nenin 7 të LPP-së nuk çënohen, pasi kriteri zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Ky kriter nuk kufizon konkurrencën, por siguron që vetëm operatorët që kanë personel realisht të kualifikuar për infrastrukturën Cloud të nivelit Arkitekt të marrin pjesë në procedurë. Ky formulim është i justifikuar dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën e kontratës, duke shmangur interpretimet e pasakta dhe duke siguruar një proces vlerësimi transparent e objektiv.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 8:

Ky kriter është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik të disponojë personel të specializuar në migrimin e bazave të të dhënave në mjediset Cloud, proces që përfshin: analizën e skemës së bazës së të dhënave, transformimin e strukturave, optimizimin e performancës, orkestrimin e shërbimeve Cloud dhe rikuperimin në rast dështimi. Migrimi i bazave të të dhënave në Cloud është një proces me risk të lartë teknik: gabime në këtë fazë mund të sjellin humbje të të dhënave, ndërprerje të shërbimeve kritike ose probleme të sigurisë. Për këtë arsye, kërkesa për certifikim nga prodhuesi është vendosur për të siguruar që personeli i angazhuar zotëron njohuritë dhe praktikat zyrtare të migrimit dhe integritetit të të dhënave.

Përfshirja e formulimit “ose ekuivalentë” në këtë rast nuk është e përshtatshme, pasi nuk ekziston një standard i qartë ndërkombëtar që përcakton ekuivalencën e trajnimeve apo certifikimeve të dhëna nga palë të treta. Kjo do të sillte pasiguri dhe subjektivizëm në procesin e vlerësimit të ofertave, duke cenuar transparencën dhe duke rritur rrezikun për mosfunksionim gjatë ekzekutimit të kontratës. Neni 36, pika 4, i Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i jep autoritetit kontraktor kompetencën të kërkojë certifikata specifike profesionale, si provë të kapacitetit teknik dhe profesional. Ky nen nuk detyron autoritetin kontraktor të parashikojë ekuivalencë në çdo rast, sidomos kur natyrat teknike dhe specifike të kontratës kërkojnë certifikime unike të lëshuara nga prodhuesi. Kriteri është i justifikuar dhe proporcional, pasi ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe nuk përbën diskriminim, duke u aplikuar në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Përkundrazi, mosparashikimi i këtij kriteri do të rrezikonte integritetin teknik të procesit të migrimit dhe cilësinë e shërbimit që do të ofrohet.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.”.

III.3.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.3.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.3.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.7. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;*
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.3.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.3.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin.

Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Operatori ekonomik ankimues, kërkon të modifikohet kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, duke pretenduar që për punonjësit e certifikuar nga prodhuesi, të cilët duhet të zotërojnë certifikatën “në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator” (ANKESA 4), certifikatën “Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator)” (ANKESA 5), certifikatën “për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator)” (ANKESA 6), “për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt” (ANKESA 7) dhe certifikatën “për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional” (ANKESA 8), autoriteti kontraktor duhet që për secilën certifikatë të përcaktojë edhe termin “Ekuivalent”, por pa argumentuar teknikisht dhe ligjërisht se përse vendosja e këtij termi rrit konkurrencën.

Referuar procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar se

këto certifikime janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, ku për punonjës in e pajisur me certifikatën **“në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator”** (ANKESA 4) i ka argumentuar si të domosdoshëm pasi aftësitë profesionale që fiton një punonjës i tillë janë të nevojshme për realizimin e e shërbimeve të ***instalimin, konfigurimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin (update/patching) të sistemeve operative (OS)*** sikurse përcaktohet në dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit,

ku për punonjës in e pajisur me certifikatën **“Administratorë të Bazës së të Dhënave (DBA – Database Administrator)”** (ANKESA 5) i ka argumentuar si të domosdoshëm pasi aftësitë profesionale që fiton një punonjës i tillë janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve të zhvillimeve specifike në nivelin e databazës sikurse përcaktohet në dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit,

ku për punonjës in e pajisur me certifikatën **“për infrastruktura e bazës së të dhënave “Database infrastructure” (Oracle Database 19c: RAC, ASM, and Grid Infrastructure Administrator)”** (ANKESA 6) i ka argumentuar si të domosdoshëm pasi aftësitë profesionale që fiton një punonjës i tillë janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve të instalimit, përditësimin dhe migrimit të bazës së të dhënave ne Cloud, si dhe të elementeve kritikë të saj, siç janë Grid Infrastructure dhe Automatic Storage Management (ASM), sikurse përcaktohet në dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, ku për punonjës in e pajisur me certifikatën **“për Cloud Infrastructure, të nivelit Arkitekt”** (ANKESA 7) i ka argumentuar si të domosdoshëm pasi aftësitë profesionale që fiton një punonjës i tillë janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve të migrimit të sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës “Oracle JDE” drejt një infrastrukture Cloud, proces i cili përfshin jo vetëm transferimin teknik të të dhënave dhe aplikacioneve, por gjithashtu kërkon projektim, konfigurim, optimizim dhe sigurim të një arkitekture Cloud të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe të sigurt, sikurse përcaktohet në dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, si dhe për punonjës in e pajisur me certifikatën **“për Cloud Database Migration, të nivelit Profesional”** (ANKESA 8) i ka argumentuar si të domosdoshëm pasi aftësitë profesionale që fiton një punonjës i tillë janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve të migrimit të sistemit të menaxhimit financiar të Autoritetit Portual Durrës “Oracle JDE” drejt një infrastrukture Cloud, proces i cili kërkon projektim, konfigurim, optimizim dhe sigurim të një arkitekture Cloud të qëndrueshme, të shkallëzueshme dhe të sigurt, sikurse përcaktohet në dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit.

Kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se janë të arsyeshme, proporcionale dhe në përputhje me natyrën e kontratës objekt – prokurimi, referuar dokumentit ***“TERMAT E REFERENCËS”*** të Shtojcës 8 ***“FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS”*** të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit dhe se autoriteti kontraktor nuk

ka përcaktuar një certifikatë specifike e cila lëshohet vetëm nga një organizëm i certifikuar, ndaj dhe pretendimi i ankimesit për të shtuar togfjalëshin “Ekuivalent” në këtë kriter kualifikues nuk qëndron. Për sa më sipër, pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, për sa i përket modifikimit të kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, si në vijim: “Kërkesë 2:

Kërkojmë heqjen e shënimit: “Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muajve të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës, pasi nuk është i bazuar në ligj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 9 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.6 “Kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“2.3.6 Operatoret ekonomik ofertues duhet të paraqesin Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike të ngarkuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor në formën e një tablele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit .Adresa dhe e-mail-i të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.*
- b. Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.*
- c. Nr. i faqes në katalog referuar Nr. Identifikues të artikullit të ofruar sipas listës i shënuar me një shenjë dalluse.*
- d. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/broshurë për të gjithë mallrat që do të ofrohen. Katalogët duhet të jenë të përkthyer noterizuar si dhe të markuar.*

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim.

Shënim: Kërkesat për certifikimet e mësipërme duhet të vërtetohen me Certifikatat leshuar nga prodhuesi ose Transkriptet përkatëse (të përkthyer në shqip dhe të noterizuar).

Shënim: Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 muajve të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës.”.

III.4.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë vijon:

“Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 germa c, si dhe në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesa për paraqitjen e ofertës teknike dhe katalogëve të paisjeve të sipërcituara i shërben Autoritetit Kontraktor për krijimin e një panorame të qartë mbi përputhshmërinë e produktit/eve dhe specifikimeve teknike të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesmarrës me produktin/tet dhe specifikimet teknike të kërkuara nga AK, pra qëllimi i këtij kriteri është vërtetimi nga ana e operatorit ekonomik se paisja që do të ofrohet i përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor duke bërë krahasimin ndërmjet tyre.”.

III.4.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” ShPK autoriteti kontraktor me shkresën *Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, i ka shqyrtuar këto pretendime të ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon

“PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 2:

Autoriteti kontraktor vlerëson se është e domosdoshme të ruhet një kriter që siguron vërtetimin se punonjësit e certifikuar janë realisht pjesë e stafit të operatorit ekonomik në momentin e paraqitjes së ofertës. Kjo përbën një garanci minimale për kapacitetin teknik-profesional të operatorit dhe për ekzekutimin korrekt të kontratës. Në këtë kuadër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendos të modifikojë kriterin si më poshtë:

ISHTE

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës.

BËHET

Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 1 muaji të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listëpagesave dhe kontratave të punës.

Ky modifikim është i mjaftueshëm për të garantuar se punonjësit e certifikuar janë realisht të lidhur me operatorin ekonomik dhe shmang çdo interpretim të panevojshëm si kufizues i konkurrencës. Ky ndryshim siguron balancën ndërmjet kërkesës së ligjshme të autoritetit kontraktor për të pasur garanci mbi disponueshmërinë e stafit të kërkuar dhe detyrimit për të mos vendosur kritere të panevojshme apo disproporcionale që mund të kufizojnë konkurrencën.

Për këto arsye, kërkesa pranohet pjesërisht.”.

III.4.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 *“Parime të përgjithshme”* të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.4.5. Në Nenin 21 *“Autoriteti ose enti kontraktor”* të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.4.6. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të të ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.4.7. Në nenin 41 pika 2 e 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën;

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

III.4.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës.

Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë.

Në pretendimin e tij ankimuesit, i cili kërkon modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi., duke pretenduar si në vijim: “Kërkojmë heqjen e shënimit: “Personeli i mësipërm duhet të ketë marrëdhënie pune me operatorin ekonomik për periudhën e 3 mujorit të fundit, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listepagesave dhe kontratave të punë, pasi nuk është i bazuar në ligj.””, duke pretenduar se kjo kërkesë nuk është e bazuar në ligj.

Referuar procesverbalit “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar se kërkesa e mësipërme është e bazuar në parashikimet ligjore të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Lidhur me këtë pretendim të ankimuesit, autoriteti kontraktor me shkresën *Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025*”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025 ka modifikuar kriterin kualifikues të sipërpërmendur, ku ka përcaktuar që listepagesa duhet të paraqitet vetëm për muajin e fundit nga dita e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke mos pranuar në thelb pretendimin e ankimuesit për heqjen e kërkesës për paraqitjen e listeopagesës.

Komisioni gjykon se kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, në thelb lidhet me kërkesën që operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon në stafin e tij punonjësit e kualifikuar të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi, punonjës të cilët janë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Në rastin konkret, Komisioni gjykon se kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.6 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 9 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit objekt ankimi dhe i modifikuar lidhur me paraqitjen e listepagesave për muajin e fundit është një kriter i cili është në porporcion me objektin e prokurimit, si dhe është i parashikuar nga legjisllacioni për prokurimin publik dhe konkretisht nga nenin 77 pika 1 dhe 4 të të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar dhe nenin 41 pika 2 e 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar.

Për sa më sipër, pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, si në vijim: “Kërkesë 10: AK të përcaktojë “Përmirësimin e bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi Oracle Database 19c”, si zë të veçantë në seksionin “9. Lista dhe Sasia” të specifikimeve teknike pasi ka impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike nga OE.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në Seksionin 2 “Objekti i Kontratës” dhe në pikën 2.3 “Lloji i “Kontratës”” të Seksionit 2 “Objekti i Kontratës” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar objektin e prokurimit dhe llojin e kontratës të procedurës së prokurimit , si më poshtë:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Upgrade Oracle JDE”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) : REF-60955-09-10-2025

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) :

- **Shërbimet e teknologjisë së informacionit – 7222300-0;**
- **Mirëmbajtja e softëareve të teknologjisë së informacionit – 72267100-0.**

2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Publike për Shërbime”

III.5.2. Në Seksionin 2.1 “Objektivi i Përgjithshëm” të dokumentit “TERMAT E REFERENCËS” të Shtojcës 8 “FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar termat e referencës së shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

2.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është:

- *Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud.*
- *Permiresim i sistemit sistemi i administrimit financiar Oracle JDE (Oracle JD Edäards EnterpriseOne 9.1 ne 9.2) dhe përditësim i tij nga Oracle JD Edäards EnterpriseOne 9.1 ne sistemin e permiresuar Oracle JD Edäards EnterpriseOne 9.2 duhet perfshire permiresimin e komponentet Oracle JD Edäards Tools dhe Oracle EëbLogic Server në versionin më i fundit të disponueshëm nga Oracle për Tools Release. Sistemi i përditësuar duhet të jetë “code current” (me datë - data e fillimit të projektit) ku modifikimet/përshtatjet e përzgjedhura/konfirmuara të*

transferohen ne sistemin e ri.Gjithashtu sistemi i perditesuar duhet të jetë në përputhje me (Minimum Technical Requirements)-të e Oracle për JD Edëards.

- Permiresim i bazes se te dhenave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g ne minimumi Oracle Database 19c.
- Migrimi i te dhenave.
- Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e aplikacionit nga Eëindoës server 2008 R2 (64 bit) ne Eëindoës Server 2019 ose me lart.
- Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e bazes se te dhenave nga Red Hat Linux ne min, Oracle Linux 8.10.
- Migrimin i sistemit të sistemi të administrimit financiar ne Platformen Cloud

III.5.3. Në shtojcën 7 “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT” të dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar lloji, sasitë dhe afati i ekzekutimit të shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Sasia
1	Krijimi i Infstruktues Cloud për Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE	1
2	Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe EëebLogic të azhurnuar	1
3	Mirembajtje 1 (nje) vit i Sistemin e Administrimit financiar Oracle JDE duke perfshire dhe Infrastrukturen Cloud	1

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7 – M19
1	Faza Përgatitore për permiresimin e sistemin softëare	X						
2	Konfigurimi i Infrastrukturës Cloud		X	X				

3	Faza e përmirësimit të sistemit softëare				X			
4	Faza e integritit dhe testimit të sistemit softëare					X		
5	Marrja në dorëzim						X	
6	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes							X

Afatet e ekzekutimit:

AFATI I EKZEKUTIMIT: 6 (gjashtë) muaj nga lidhja e kontrates

(Operatori Ekonomik Fitues do të kryejë Mirëmbajtje (1 vit) nga momenti i marrjes në dorëzim të projektit)

Referohuni dokumentacionit ngarkuar në SPE me emërtimin 2_ “Termet e References

III.5.4. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike të shërbimeve objekt prokurimi si më poshtë vijon:

“II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termet e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

III.5.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” ShPK autoriteti kontraktor me shkresën “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, i ka shqyrtuar këtë pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon

“PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 10:

Përmirësimi i bazës së të dhënave Oracle përbën një komponent integral dhe të pandashëm të shërbimit të përgjithshëm për përmirësimin e sistemit financiar JD Edëards. Ky element është i mbuluar tashmë në mënyrë të qartë nga përshkrimi i zërit nr. 2 në seksionin “9. Lista dhe Sasia”, ku përcaktohet: “Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe ËebLogic të azhurnuar.”

Përmirësimi i JD Edëards në versionin 9.2 me komponentët e rinj të Tools Release dhe ËebLogic nënkupton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme edhe azhurnimin e bazës së të dhënave Oracle, pasi kjo është shtylla themelore mbi të cilën funksionon sistemi JD Edëards. Çdo version i ri i Tools Release dhe ËebLogic kërkon përputhshmëri të plotë me versionin e bazës së të dhënave, përndryshe sistemi nuk mund të operojë në mënyrë stabile, të sigurt dhe në përputhje me standardet e rekomanduara nga prodhuesi. Në këtë kuadër, përmirësimi i bazës së të dhënave nuk është një aktivitet i ndarë apo shtesë, por një nënkomponent teknik i domosdoshëm i përfshirë brenda objektit të shërbimit të përmirësimit të JD Edëards.

Nuk konsiderohet e nevojshme që përmirësimi i bazës së të dhënave Oracle të shtohet si një zë i veçantë në seksionin “9. Lista dhe Sasia”, pasi ai është tashmë i integruar në përmbajtjen teknike të zërit ekzistues nr. 2 dhe përbën pjesë organike të këtij shërbimi.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.”.

III.5.6. Lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor përsa i përket pretendimit të sipërpërmendur të ankimuesit, operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” ShPK më datë 09.10.2025 ka paraqitur prapësimet e tij, si më poshtë vijon;

“PËRGJIGJE NDAJ përgjigjes së KSHA për ANKESËN NR. 10:

Në dokumentin “2_Termat_e_References.docx” (fq. 3), objektivi i përgjithshëm parashikon qartazi:

*“Përmirësim i bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi **Oracle Database 19c.**”*

*Megjithatë, në seksionin “9. Lista dhe Sasia” ky zë mungon plotësisht. Në dokumentet e prokurimit, “Lista dhe Sasia” përfaqëson strukturën buxhetore dhe ekonomike mbi të cilën bazohet oferta financiare e operatorëve. **Mospërfshirja e këtij zëri në tabelë përbën mospërputhje substanciale ndërmjet objektivit teknik dhe bazës së llogaritjes financiare të tenderit.***

Oracle Database është një produkt dhe shtresë teknike e veçantë në arkitekturën e sistemit JD Edëards. Ndërsa JD Edëards Tools Release dhe ËebLogic kërkojnë përputhshmëri me versionet e bazës së të dhënave, përmirësimi i Oracle Database-it nuk kryhet automatikisht si pjesë e instalimit të JD Edëards.

Në praktike, ky përmirësim përfshin:

- krijimin e backup-eve të plotë,
- eksportimin dhe migrimin e skemave,
- konvertimin e parametrave,

- testimin e performancës dhe integritetit,
- konfigurimin e replikimit dhe të lidhjeve ODBC/JDBC.

Këto faza kanë kohëzgjatje, burime dhe kosto të veçanta, prandaj duhen trajtuar si zë i dallueshem në listën e ofertimit.

Kërkesë 10:

AK të përcaktojë “Përmirësimin e bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi Oracle Database 1Gc”, si zë të veçantë në seksionin “9. Lista dhe Sasia” të specifikimeve teknike pasi ka impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike nga OE.”.

III.5.7. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.5.8. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke

garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

III.5.9. Në pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.5.10. Lidhur me pretendimet e mësipërme të parashtruara nga operatori ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK në Ankesën nr.10, si dhe nisur nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt “**Upgrade Oracle JDE**”, kontratë të cilën e ka klasifikuar si një kontratë shërbimi, ndërkohë që në Seksionin 2.1 “Objektivi i Përgjithshëm” të dokumentit “**TERMAT E REFERENCËS**” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**” të dokumentave të tenderit ka përcaktuar specifikimet teknike të shërbimeve objekt prokurimi dhe të nevojshme për përmirësimin e sistemit “Oracle JDE”, ndërsa në shtojcën 7 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumentave të tenderit të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronik (SPE), autoriteti kontraktor ka publikuar llojin dhe sasinë e shërbimeve objekt prokurimi.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të sipërpërmendura të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni konstaton se ankimuesi kërkon që të modifikohet shtojca 7 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” e dokumentave të tenderit, duke shtuar si zë të veçantë në preventivin e shërbimeve edhe zërin e “Përmirësimin e bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi Oracle Database 19c”.

Lidhur me këtë pretendime të ankimuesit, autoriteti kontraktor në shkresën “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025 ka arsyetuar si në vijim: “**PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 10:**

Përmirësimi i bazës së të dhënave Oracle përbën një komponent integral dhe të pandashëm të shërbimit të përgjithshëm për përmirësimin e sistemit financiar JD Edëards. Ky element është i mbuluar tashmë në mënyrë të qartë nga përshkrimi i zërit nr. 2 në seksionin “9. Lista dhe Sasia”, ku përcaktohet: “Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe ËebLogic të azhurnuar.”

Përmirësimi i JD Edëards në versionin 9.2 me komponentët e rinj të Tools Release dhe ËebLogic nënkupton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të domosdoshme edhe azhurnimin e bazës së të dhënave Oracle, pasi kjo është shtylla themelore mbi të cilën funksionon sistemi JD Edëards. Çdo version i ri i Tools Release dhe ËebLogic kërkon përputhshmëri të plotë me versionin e bazës së të dhënave, përndryshe sistemi nuk mund të operojë në mënyrë stabile, të sigurt dhe në përputhje me standardet e rekomanduara nga prodhuesi. Në këtë kuadër, përmirësimi i bazës së të dhënave nuk është një aktivitet i ndarë apo shtesë, por një nënkomponent teknik i domosdoshëm i përfshirë brenda objektit të shërbimit të përmirësimit të JD Edëards.

Nuk konsiderohet e nevojshme që përmirësimi i bazës së të dhënave Oracle të shtohet si një zë i veçantë në seksionin “9. Lista dhe Sasia”, pasi ai është tashmë i integruar në përmbajtjen teknike të zërit ekzistues nr. 2 dhe përbën pjesë organike të këtij shërbimi.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet, duke mos pranuar pretendimet e ankimesit.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, si dhe nisur nga argumentat e parashtruara nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni gjykon se pretendimi i ankimesit nuk qëndrojnë, pasi nga shqyrtimi i Seksionit 2.1 “Objektivi i Përgjithshëm” të dokumentit “**TERMAT E REFERENCËS**” të Shtojcës 8 “**FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS**” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar se pjesë e shërbimit të përmirësimit të sistemit “**Oracle JDE**” është edhe kryerja e shërbimit si në vijim: “**Përmirësim i bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi Oracle Database 19c**”, shërbim i cili është i përfshirë në zërin si në vijim: “*Përmirësimi i JD Edëards në versionin më të fundit 9.2 me Tools Release dhe ËebLogic të azhurnuar*”, i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në shtojcën 7 “**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**” të dokumentave të tenderit, si dhe për më tepër autoriteti kontraktor si përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike, të termave të referencës dhe i preventivit të shërbimeve objekt prokurimi ka parashikuar që përmirësimi i sistemit “**JD Edëards**” në versionin më të fundit “*9.2 me Tools Release dhe ËebLogic të azhurnuar*” përfshin edhe shërbimin si në vijim: “**Përmirësim i bazës së të dhënave nga Oracle Database Enterprise Edition 11g në minimumi Oracle Database 19c**”, duke përllogaritur edhe koston e këtij shërbimi në vlerën e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër pretendimi i mësipërm i operatorit ekonomik ankimes “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” SHPK, si në vijim: “**ANKESË 9**”

Në dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termit_e_Referencës.docx” në faqe 19 përcaktohet se “... Vendosija e një strukture të saktë sigurie do të kufizojë gjithashtu aksesin në module pa licencë.

Me JD Edëards 9.2 ekziston mundësia për të implementuar Single Sign-On duke përdorur Microsoft Entra ID dhe Oracle IDCS për të rritur komoditetin për përdoruesit, duke sjellë opsione si autentifikimi me dy faktorë dhe menaxhimi i centralizuar i fjalëkalimeve...”

Nuk është e përcaktuar në dokumentin e specifikimeve teknike nëse OE do të duhet të implementojë ENTRA ID, apo thjeshtë “ të ekzistojë mundësia” për implementim pasi ekziston rreziku që AK të kërkojë gjatë zbatimit të kontratës që OE të implementojë ENTRA ID dhe kjo ka impakt financiar.

Kërkesë 9:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike nëse OE duhet të implementojë ENTRA ID, pasi ka impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike.

ANKESË 13

Në dokumentin e specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi “2_Termat_e_Referencës.docx” në faqe 7 përcaktohet se duhet të realizohet “... ne sistemin e permiresuar Oracle ËebLogic Server 9.2 duhet perفشire permiresimin e komponentet Oracle JD Edëards Tools dhe Oracle ËebLogic Server në versionin më i fundit...”, por versioni i fundit i Oracle Ëeblogic Server është 14. AK në dokumentin e specifikimeve teknike nuk e ka përcaktuar vërsionin e fundit. Ky fakt shkaton konfuzion tek OE dhe AK gjatë realizimit të kontratës mund të kërkojë pretendime të ndryshme që kanë impakt financiar.

Kërkesë 13:

AK të përcaktojë në dokumentin e specifikimeve teknike versionin e saktë të Oracle ËebLogic Server për sistemin e përmirësuar JDE, pasi kanë impakt financiar në përgatitjen e ofertës ekonomike .”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në Seksionin 2.1 “Objektivi i Përgjithshëm” dhe në Seksionin 12.2.3 “Fortësimi i sigurisë” të dokumentit “*TERMAT E REFERENCËS*” të Shtojcës 8 “*FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar termat e referencës së shërbimeve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

2.1 Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është:

- Migrimin i infrastrukturës së sistemit të administrimit financiar ne Platformen Cloud.
- Permiresim i sistemit sistemi i administrimit financiar Oracle JDE (Oracle JD Edëards EnterpriseOne 9.1 ne 9.2) dhe përditësim i tij nga Oracle JD Edëards EnterpriseOne 9.1 ne sistemin e permiresuar Oracle JD Edëards EnterpriseOne 9.2 duhet perفشire permiresimin e komponentet Oracle JD Edëards Tools dhe Oracle ËebLogic Server në versionin më i fundit të disponueshëm nga Oracle për Tools Release. Sistemi i përditësuar duhet të jetë “code current” (me datë - data e fillimit të projektit) ku modifikimet/përshatatjet e përzgjedhura/konfirmuara të

transferohen ne sistemin e ri.Gjithashtu sistemi i perditeluar duhet të jetë në përputhje me (Minimum Technical Requirements)-të e Oracle për JD Edëards.

- Permiresim i bazes se te dhenave nga **Oracle Database Enterprise Edition 11g** ne minimumi **Oracle Database 19c**.
- Migrimi i te dhenave.
- Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e aplikacionit nga **Ëindoës server 2008 R2 (64 bit)** ne **Ëindoës Server 2019** ose me lart.
- Permiresim e sistemit te Operimit per serverin e bazes se te dhenave nga **Red Hat Linux** ne min, **Oracle Linux 8.10**.

Migrimin i sistemit të sistemi të administrimit financiar ne Platformen Cloud

...

12.2.3. Fortësimi i sigurisë

Do të duhet që gjatë përditësimit, të konsiderohet rishikimin e të drejtave të përdoruesve dhe kufizimin e aksesit.

Vendosja e një strukture të saktë sigurie do të kufizojë gjithashtu aksesin në module pa licencë. Me JD Edëards 9.2 ekziston mundësia për të implementuar Single Sign-On duke përdorur Microsoft Entra ID dhe Oracle IDCS për të rritur komoditetin për përdoruesit, duke sjellë opsione si autentifikimi me dy faktorë dhe menaxhimi i centralizuar i fjalëkalimeve.

Për bazën e të dhënave, versioni më i fundit i JD Edëards mbështet më mirë privilegjet e bazës së të dhënave duke përdorur rolet e reja si:

- **JDEADMIN** (krijimi i tabelave/indekseve, leximi/shkrimi i tabelave)
- **JDEUSER** (leximi/shkrimi i tabelave)

Rekomandohet fuqimisht implementimi i këtij modeli.

III.6.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, të publikuar në SPE autoriteti kontraktor ka argumentuar përcaktimin e specifikimeve teknike të shërbimeve objekt prokurimi si më poshtë vijon:

“II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e

ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.”.

III.6.3. Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” ShPK autoriteti kontraktor me shkresën “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, i ka shqyrtuar këtë pretendim të ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon

“PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 9:

Në Termat e Referencës është përcaktuar qartë se implementimi i këtij modeli rekomandohet fuqimisht, duke pasqyruar një qasje orientuese dhe jo detyruese. Për këtë arsye, nuk është e nevojshme të bëhen përcaktime shtesë apo ndryshime në dokumentin e Specifikimeve Teknike, pasi përmbajtja ekzistuese e pasqyron në mënyrë të plotë natyrën rekomanduese të përdorimit të Entra ID.

Operatorët ekonomikë janë të lirë të marrin një vendim teknik në përputhje me arkitekturën e tyre të propozuar dhe të ofrojnë, nëse e shohin të arsyeshme, zgjidhje alternative të barasvlershme funksionalisht për menaxhimin e identiteteve dhe autentifikimit. Kushti i vetëm është që zgjidhja e propozuar të jetë teknikisht e argumentuar dhe të sigurojë përmbushjen e qëllimeve funksionale të projektit, si: siguria, integriteti i të dhënave, menaxhimi i aksesit dhe shkallëzueshmëria e sistemit.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet.

...

PËRGJIGJE NDAJ ANKESËS NR. 13:

Formulimi në dokumentin e Termave të Referencës është bërë në mënyrë të qëllimshme fleksibël dhe të qartë, duke përcaktuar: “Në sistemin e përmirësuar Oracle JD Edëards EnterpriseOne 9.2 duhet të përfshihet përmirësimi i komponentëve Oracle JD Edëards Tools dhe Oracle EëbLogic Server në versionin më të fundit të disponueshëm nga Oracle për Tools Release.”

Ky formulim siguron përputhje me politikat dhe praktikat më të mira të Oracle, të cilat kërkojnë që komponentët e JD Edëards të certifikohen dhe mbështeten vetëm në kombinim me versione specifike të EëbLogic Server.

Duke marrë parasysh se gjatë periudhës së tenderimit Oracle mund të publikojë versione të reja, është saktësuar që do të pranohet versioni më i fundit i disponueshëm dhe i mbështetur zyrtarisht nga Oracle deri në ditën e fundit të pranimit të ofertave në sistemin e prokurimit publik. Ky përcaktim garanton që sistemi i përmirësuar të jetë në përputhje teknike me kërkesat zyrtare të Oracle në momentin e ofertimit, duke shmangur çdo rrezik të mosmbështetjes teknike gjatë zbatimit të kontratës.

Për këtë pikë kërkesa nuk pranohet “.

III.6.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.6.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.6.6. Neni 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë

që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.

III.6.7. Neni 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë të palëve të interesuara, mund të vendosë të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit përmes hartimit të një shtojce. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e parë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor mund të zgjasë afatin kohor të pritjes së ofertave. Nëse ndryshimi i dokumenteve të tenderit bëhet në gjysmën e dytë të afatit të pranimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 10 ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe me të paktën 7 ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

3. Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës.”.

III.6.8. Në nenin 41, pika 1 dhe pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit, do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”.

Ndërsa në nenin 15, pika 3 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos/ mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.¹⁶

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e lëvrimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.”.

III.6.9. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Lidhur me pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK, të parashtruara në pikën III.6. të këtij vendimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për këto pretendime të ngritura në formën e sqarimit dhe autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit me shkresën “Kthim përgjigje ankesës me Nr. Aplikimi A/2025/5567, datë 17.07.2025”, protokolluar me tonën me nr. 2528/1 prot, datë 23.09.2025, nuk ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me këto konstatime të operatorit ekonomik ankimues,.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për këto pretendime të ngritura në formën e sqarimit, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me këto konstatime të operatorit ekonomik ankimues, prandaj duhet të sqarojë ankimuesin në mënyrë shteruese lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik, nesë shërbimet objekt prokurimi përfshijnë edhe implementimin e programit ‘ENTRA ID’, si dhe duhet të përcaktojë versionin e saktë të programit “Oracle EëbLogic Server” për sistemin e përmirësuar “Edëards JDE”.

Akoma më tej KPP gjykon se sqarimi në rastin konkret është i nevojshëm edhe në funksion të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe ngarkimin e tyre me të njëjtat të drejta dhe detyrime, duke shmangur kështu trajtimin diskriminues ndërmjet tyre, në kushtet kur mund të ndodhë që operatorë të ndryshëm të paraqesin oferta teknike dhe ekonomike jo në përputhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në sqarimet që do t’i japë ankimuesit duhet të përcaktojë qartë dhe saktë kërkesat e sipërmendura të ankimuesit, si dhe njëherazi të bëjë publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues “Advanced Business Solutions - ABS” SHPK qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” ShPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-60955-09-10-2025*, me objekt: “*Upgrade Oracle JDE*”, me fond limit 14.959.147,03 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*Advanced Business Solutions - ABS*” ShPK për procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-60955-09-10-2025*, me objekt: “*Upgrade Oracle JDE*”, me fond limit 14.959.147,03 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 01.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Portual Durrës
 3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*Advanced Business Solutions - ABS*” ShPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

